



*P***NË PRAG TË** *Pushimeve*



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

"Drita islame"
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

REDAKTORË
Andrin Rasha
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Ejup Lila

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXX i botimit
Nr. 06 (461)
Qershor, 2021

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,
nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.
Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA


- 4 Në prag të pushimeve / Redaksia
- 6 Të paharruara qofshin gjurmët e tua / Qani Sulku
- 8 Lajme / Aktivitete



- 12 Për çfarë kemi nevojë (1) / Nuredin Nazarko
- 14 Shpirti i civilizimit islam / Dr. Muhammed Ammareh
- 18 Mbrojtja për të dobëtit dhe të privuarit nga e drejta, është cilësi e njerëzve të mëdhenj dhe fisnikë / Ed'hem Sherkaui
- 20 Kudsi, kjo kujtesë e harruar / Abdullah Bulku
- 22 Ebu Hurejra , nga jeta e një transmetuesi të dashur / Hamzah Kasim
- 24 Një histori e shkurtër e Palestinës / Haki Sahitaj



- 28 Haxhi Ali Derhemi (1850-1938)
- 30 Xhamia Mbret, Elbasan
- 32 Frika nga vdekja, në një këndvështrim ndryshe / Aisa Kokiqi
- 34 Radioterapia, një teknologji premtuese për terapinë tumorale / Përkthim nga Erion Sukaj
- 38 Dy rrëfenja popullore



P NË PRAG TË Pushimeve

Ja dhe shkolla mbaroi për këtë vit. Bashkë me përfundimin e një viti shkollor, prindërit i shqetëson më shumë mendimi se si fëmijët do t'i kalojnë këto pushime.

Çdo prind dëshiron që fëmija i tij të lexojë, të punojë ekstra në lëndët ku ka çaluar gjatë vitit shkollor dhe t'i shfrytëzojë pushimet në mënyrën e duhur, por, në të vërtetë, ata përballen me dembelizmin, përtacinë, varësinë ndaj televizorit dhe pajisjeve teknologjike. Jo çdo fëmijë mund të shprehë dëshirën të ndjekë programin e dëshiruar të prindit. Prandaj, para fillimit të sezonit veror, është shumë e rëndësishme të flisni dhe të diskutoni bashkë me fëmijët tuaj (për/rreth) mënyrën se si do ta shfrytëzojnë verën dhe planin që duhet të bëni në mënyrë që këto 3 muaj të gjatë të mos shndërrohen në tre muaj, të cilët nxisin mërzinë dhe depresionin.

Pushimet verore mundësojnë zhvillimin, zbulimin e aftësive, maturimin e fëmijëve. Një kohë kaq e bollshme duhet kaluar me një plan, sa efektiv, aq dhe produktiv. Më poshtë do të japim disa këshilla për prindërit:

Pikë së pari, nxiteni fëmijën të ndajë me ju ndjenjat pozitive dhe negative të lidhura me dëftesën. Përpiquni të jeni të sigurtë me të dhe mos përdorni fjalë apo ton ofendues nëse ai ka dalë me rezultate të padëshiruara. Ndërtoni empatinë e duhur dhe kuptoni ndjenjat e tij. Mos kaloni shumë kohë duke vlerësuar dëftesën, sepse kjo do të krijojë një ndjenjë presioni te fëmija.

Diskutoni me fëmijën se si mendon t'i shfrytëzojë pushimet verore dhe cilat janë fushat ku mendon të fokusohet.

Bëjani të ditur se ju jeni të gatshëm t'i jepni ndihmën dhe mbështetjen e kërkuar.

Përpiquni të njihni fëmijën tuaj, të vlerësoni objektivisht anën e tij pozitive e negative, dhe të arrini që t'ia transmetoni këtë edhe atij. Për këtë arsye përgatisni mundësinë ku ai të shpalosë aftësitë dhe talentin.

Mos bëni plan në vend të fëmijës tuaj, por planifikoni bashkë me të. Shumë familje përjetojnë debate në lidhje me përcaktimin e një plani veror. Zakonisht prindërit mbajnë dy qëndrime, atë autoritar, ku bëhet çfarë mendon e thotë prindi, dhe atë shumë demokratik, ku vendimi lihet në dorë të fëmijës. Në këtë rast debatet përfundojnë me fitoren e njëres palë dhe humbjen e tjetrës. Shtëpia nuk duhet të kthehet në një fushëbetejë ku shpaloset autoriteti dhe fuqia, por një vend ku ndahet dashuria dhe përgjegjësitë.

Përpiquni të gjeni një rrugë të mesme ku të harmonizohen dëshirat tuaja dhe të fëmijës. Dhe mos harroni: Përpilimi i një plani është shumë herë më efektiv se indiferentizmi dhe mos-përpilimi i tij.

Ja disa këshilla të arta:

Dëftesa të mos vendoset në qendër të vëmendjes: Pas vlerësimit objektiv të dëftesave të dobëta fëmijëve u duhet dhuruar dashuri dhe siguri. Qëndroni larg krahasimit të fëmijës suaj me fëmijë të tjerë. Fëmijët që kanë marrë një dëftesë shembullore duhen falënderuar për përpjekjet e bëra.

Të mos bëhemi robër të internetit: Pajisjet teknologjike si: telefoni, tableta, kompjuteri, etj., nuk duhen përdorur në mënyrë të pakontrolluar. Mungesa e kontrollit sjell varësi dhe humbje përqendrimi te fëmijët. Nëse prindërit nuk



bëjnë një plan veror, atëherë fëmijët do ta kalojnë të gjithë verën para televizorit apo internetit. Në këtë mënyrë do të pengohet zhvillimi mendor dhe fizik i tyre dhe do t'i hapet rrugë shumë problemeve.

Të vlerësohen kurset e gjuhëve të huaja: Regjistrimi në një kurs gjuhe do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e fëmijëve. Krahas kësaj, këto kurse ndikojnë në përdorimin efektiv të kohës dhe planifikimin më frytdhënës të verës.

Të përpilohet një listë e librave që mund të lexohen: Lista duhet të përpilohet duke u bazuar në nivelin dhe dëshirat e fëmijës. Nxitja e fëmijëve në zbatimin e përmbajtjes së kësaj liste përbën një hap të rëndësishëm. Nëse është e mundur, leximi i librave të bëhet familjarisht, duke bërë analizën dhe diskutimin rreth vendeve më të pëlqyera. Mund të caktohen orare të veçanta të leximit bashkë si familje.

Forcimi i marrëdhënieve familjare: Kalimi i pushimeve verore pranë të afërmeve apo kushërinjve mund të ndikojë pozitivisht në forcimin e marrëdhënieve familjare. Duke u bërë vizita familjarëve, fëmijët arrijnë të kuptojnë shpirtin e familjes dhe të zbulojnë rëndësinë e bashkimit.

Të organizohen shëtitje: Vizita e qyteteve të ndryshme apo edhe shteteve, nëse mundësitë ekonomike e lejojnë, gjallëron dhe pasuron mendjen e fëmijëve me vlera kulturore e historike.

Të frekuentohen kurse sportive, muzike apo pikturë: Kurset verore mundësojnë zbulimin e aftësive dhe talenteve të fëmijëve dhe ndihmojnë zhvillimin e ndjenjave estetike. Për këtë mund të shihen kurset e muzikës, pikturës, etj.

TË PAHARRUARA QOFSHIN *gjurmët e tua*



Mbi tokën e kësaj bote kanë shkelur njerëz "me emër" dhe "pa emër", "të njohur" dhe "të panjohur", por sot të gjithë janë harruar, përveç disave që janë të paktë në numër, por të mëdhenj në vepra. Kjo botë i mundi të gjithë dhe nuk mbajti asnjë për vete, por i dërgoi drejt një bote tjetër. E tillë është kjo dynja; të bën për vete dhe pastaj të hedh pa pikë mëshire, prandaj dhe njeriu nuk duhet të lidhet fort pas saj, duke e ditur realitetin e saj. Kur na vdes dikush i afërt, ne e kujtojmë shpesh atë dhe e vizitojmë te varri i tij, në ato ditët, javët apo muajt e parë, por sa më shumë kalon koha, aq më rrallë e kujtojmë dhe aq më rrallë e vizitojmë. Ndarja nga njerëzit e dashur është e vështirë dhe disa mezi e përballojnë, por, me kalimin e kohës, dhimbja sa vjen dhe lehtësohet. Me vdekjen e dikujt nuk ndalet jeta, ajo vazhdon, kështu që njeriu i gjallë vijon përditshmërinë e tij, pavarësisht humbjes së njerëzve të zemrës, sepse fundja-fundit, i gjalli me të gjallët dhe i vdekuri me të vdekurit. Ngushëllimi i njohur, që qarkullon nëpër raste vdekjesh, është: "I paharruar qoftë kujtimi i tij/saj!" Apo: "Të rroni dhe ta kujtoni!". Sa shpesh i kujtojmë gjyshërit tanë, po stërgjyshërit, ndoshta nuk i mbajmë mend fare, ndoshta nuk ua dimë as emrat, ndoshta nuk ua dimë as varret ku prehen. Po neve, a do na kujtojnë dhe a nuk do të na harrojnë nipat apo stërnipat dhe stërmbesat tona?

Njeriu e lëndon shumë fakti, nëse dikush e harron për së gjalli dhe nuk kujtohet për të, aq më tepër të afërmit e tij (fëmijë, motra, vëllezër...), por edhe pas vdekjes; e lëndon fakti nëse nuk kujtohet askush, qoftë për të bërë edhe një dua (lutje) për të, apo t'i shkojë për vizitë te varri i tij, apo për të dhënë sadaka në emrin e tij. Kështu që njeriu, duhet të marrë masa paraprakisht, që të mos e përjetojë diçka të tillë, qoftë në jetë, por edhe pas vdekjes, por a është e realizueshme kjo? Përgjigja është: Po.

I dashuri ynë i zemrave, profeti Muhamed (alejhis-selam), na ka njoftuar se me vdekjen e njeriut, jo çdo gjë ndërpritet, e ndër ato që ndikojnë në vazhdimin e sevapeve për të, edhe pse nuk i përket më kësaj bote, janë punët dhe veprat e tij, prej të cilave përfitojnë të gjallët. Nëse ka kontribuar në hapjen e një pusi, do të shpërblehet për çdo njeri që pi, apo furnizohet me ujë nga ai pus; nëse ka kontribuar sadopak për ndërtimin e një xhamie, do të shpërblehet për këdo që falet në atë xhami, edhe pse ai vetë mund të ketë qindra vite i vdekur; nëse ka kontribuar në ndërtimin e një shkolle, apo vatër dijeje, për çdo person që mëson aty, atij i shkruhet sevapi dhe i bashkëngjitet peshores së punëve të mira. Nëse ndërton një rrugë, me të cilën lehtëson transportin e njerëzve,

apo bashkimin midis zonave të populluara...dhe shembujt e mirësisë nuk kanë të mbaruar për këdo që dëshiron dhe synon t'ia shtojë vetes veprat e mira dhe sevapet, për aq kohë sa vazhdon edhe përfitimi nga ajo që ai apo ajo ka bërë. Për t'i bërë këto që u përmendën më lart, apo edhe shumë e shumë të tjera, nuk është kusht të jesh i pasur nga ana financiare, por mjafton të kesh dëshirën e mirë për t'i realizuar, nijetin e pastër për hir të Zotit të Lartësuar dhe për të arritur kënaqësinë e Tij, si dhe përpjekjen e vazhdueshme, dhe të pandërprerë, për t'ia arritur. Nëse plotësohen këto komponentë, dije mirë dhe të jesh i sigurt se edhe Allahu me fuqinë e Tij absolute ka për të të ndihmuar në kryerjen e tyre dhe në lehtësimin e sipërmarrjeve të tua bamirëse. Mirësia është i vetmi investim që nuk falimenton kurrë, frytet e së cilës do t'i vjelësh për sa kohë je gjallë, por më e rëndësishmja, ato do të të vijnë pa pushim edhe pas vdekjes tënde.

Nuk është me rëndësi sa jetove, sa pasuri fitove, ku banove, apo ku dhe kur vdiqe. Me rëndësi është çfarë gjurmësh le sa ishe gjallë, por edhe pasi ike. Ata që ne i quajmë "Njerëz të mëdhenj" apo në thonjëza "Njerëz të pavdekshëm", ishin njerëz si ne, me trup dhe me shpirt, por ajo që i diferencoi dhe u dha epitetet që sapo thamë, ishte pikërisht vepra e tyre e mirë në dobi të njerëzimit, kontributi i tyre i çmuar dhe i pakursyer, që dhanë pa pushim. Nuk ishte as jetëgjatësia e as prejardhja tyre, apo pasuria që ata posedonin. Nëse edhe ti dëshiron të lësh gjurmë që mbesin gjithmonë, atëherë para teje ke shembullin më të mirë, ndiq gjurmët e të dashurit tonë, Muhamed Mustafasë, gjurmë që të shndërrojnë në të paharrueshëm gjatë jetës dhe pas vdekjes tënde. Mos e prit vdekjen duarbosh, por nisja që tani dhe investo për atë që të pret në botën tjetër, për atë që t'i ndriçon errësirat; për atë që t'i zgjeron ngushticat; për atë që të shpëton prej zjarrit të Xhehenemit; për atë që bëhet shoqëruesi yt më i mirë dhe të largon nga vetmia në jetën e varrit; për atë që të ndihesh krenar që e ndoqe rrugën dhe udhëzimin e tij, dhe mbi të gjitha për të siguruar vendin e pavdekësisë, mejdanin e lumturisë, ndjenjën e rehatisë, Xhenetin, çmimin më të lartë të Allahut. Xheneti nuk është i lirë dhe nuk fitohet kollaj, prandaj, le ta lusim Zotin tonë që të na e bëjë të dashur Xhenetin dhe të na pajisë me vullnet të hekurt për të punuar fort dhe për ta merituar atë. S'ka dyshim se Allahu i shpërblen punëmirët dhe bamirësit me gradat më të larta të Parajsës, si dhe i vendos nën shoqërinë e zotërisë së njerëzimit, Muhamedit alejhi selam. Allahu na bëftë prej tyre!

Amin.



1

FALJA E FITËR BAJRAMIT

Besimtarët myslimanë rikthehen në shesh për faljen e Fitër Bajramit, pas një shkëputje për shkak të pandemisë COVID-19. Mijëra besimtarë myslimanë falën, më datë 13. 05. 2021, namazin e Fitër Bajramit në sheshin "Skënderbe" në Tiranë dhe mijëra të tjerë në sheshet kryesore të çdo qyteti të vendit.

Festimet e Fitër Bajramit filluan që në orët e para të mëngjesit me faljen e namazit të sabahut.

Më pas programi i Bajramit filloi me këndimin e një pjesë nga Kur'ani Famëlartë, të cilën e përcolli imami i xhamisë së "Et'hem Beut", z. Elton Karaj.

Ceremonia vazhdoi me fjalën përshëndetëse të Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili përcolli për të pranishmit urimet dhe përshëndetjet e kësaj dite gëzimi për të gjithë besimtarët myslimanë shqiptarë.

Në ligjëratën e rastit, Nënkryetari i Komunitetit Mysliman, z. Taulant Bica, pasi uroi të pranishmit për Fitër Bajramin u fokusua te kujdesi dhe vëmendja ndaj familjes dhe rinisë.

Më tej u fal namazi i bajramit nga Kryetari i Komunitetit, H. Bujar Spahiu, për të vazhduar më pas me hytben e Fitër Bajramit, e cila u mbajt nga Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli.

Gjatë hytbes, myftiu Luli, u lut për më shumë paqe, kënaqësi, gëzim dhe harmoni mes njerëzve të shoqërisë sonë.

Më pas besimtarët e pranishëm në shesh u shpërndanë për të festuar me familjet dhe të afërmit e tyre.





2

VIZITAT ME RASTIN E FITËR BAJRAMIT

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë hapi dyert për të pritur urimet me rastin e Fitër Bajramit.

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahi, priti urime nga përfaqësuesit e komuniteteve fetare të vendit tonë, nga Presidenti i Republikës, Z. Ilir Meta, Ministria e Kulturës, Znj. Elva Margariti, Kryetari i Partisë Demokratike, Z. Lulzim Basha, Prefekti i Tiranës, Z. Mersin Murataj, Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Znj. Monika Kryemadhi, Nënkryetari i Bashkisë së Tiranës, Z. Andi Seferi, Kryetari i Këshillit të Qarkut, Z. Aldrin Dalipi, Kryetarja e Komiteti Shtetëror të Kulteve, Znj. Loreta Aliko, drejtues të institucioneve shtetërore e lokale, publike e private.

Urimet e tyre i përcollën edhe ambasadorja e Shteteve të Bashkuara në Tiranë, znj. Yuri Kim, ambasadorët e vendeve të Bashkimit Europian dhe vendeve të tjera mike.

Gjithashtu, urimet e tyre i përcollën Kryetarit Spahi edhe Rektori i Universitetit të Tiranës, Prof. Dr. Artan Hoxha, akademikë të tjerë, personalitete të jetës publike, të fushës së artit, medias, biznesit, etj.

Në mesazhet e tyre drejtuar kreut të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiut, ata shprehën urimet dhe përsëritjet e tyre të sinqerta për sakrificën e besimtarëve myslimanë gjatë muajit të bekuar të Ramazanit, që sapo lamë pas, si dhe uruan besimtarët për më shumë mirësi.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë falënderon të gjithë ata që morën pjesë në këto vizita si dhe të gjithë shqiptarët që kanë dërguar mesazhe urimi me rastin e kësaj feste.





3

TAKIM ME KRYETAREN E SHOQATËS “SHTËPIA E BAMIRËSISË”

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, me datë 21. 05. 2021, priti në një takim Znj. Wedad Al-Sewaidi nga Kuvajti.

Zonja Al-Sewaidi është kryetare e Shoqatës “Shtëpia e Bamirësisë”, e cila ushtron aktivitetin e saj prej shumë vitesh edhe në vendin tonë.

Kjo shoqatë ka kryer disa bashkëpunime me karakter humanitar me KMSH, si ardhja në ndihmë e fëmijëve jetimë dhe të varfërve nëpërmjet pakove ushqimore për Ramazan dhe Fitër Bajram.

Po ashtu, nëpërmjet këtij bashkëpunimi, janë mundësuar disa ndërhyrje rikonstruksioni në objektet e kultit në disa zona të vendit.

Kryetari Spahiu vlerësoi dhe falënderoi Znj. Al-Sewaidi për këtë bashkëpunim, dhe shtoi se ky bashkëpunim do të intensifikohet edhe më shumë në të ardhmen.

Znj. Al-Sewaidi u shpreh e kënaqur nga fryma dhe klima pozitive që ka gjetur gjatë bashkëpunimit të deritanishëm me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë dhe suportin personal që i ofron kësaj klime vetë Kryetari Spahiu.

Ajo shtoi gjithashtu se do të vazhdojë mbështetja konkrete edhe më tutje me të tjera projekte.

4

WORKSHOP NË BILISHT DHE POGRADEEC NË KUADËR TË PROJEKTIT “ANGAZHIMI I TË RINJVE PËR NJË KOMUNITET TË QËNDRUESHËM”

Në kuadër të projektit “Angazhimi i të rinjve për një komunitet të qëndrueshëm”, projekt i mbështetur nga Ambasada e SHBA-ve në Tiranë dhe zbatuar nga Komunitetit Mysliman i Shqipërisë, u zhvillua “Faza2” e Workshop-it në qytetet juglindore të vendit. Ky ishte një sesion informues për fazën aktuale të projektit.

Projekti është i shtrirë në 6 bashki të ndryshme në Republikën e Shqipërisë.

-Fokusi i projektit është në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet një seri seminaresh, workshop-esh, konferencash dhe aktiviteteve sociale, kulturore dhe sportive.

Në të morën pjesë: Përfaqësues nga Ambasada e SHBA-ve, z. Ian Crawford dhe znj. Irena Taga, Kryetari i Bashkisë Pogradec, z. Ilir Xhakolli, Kryetari i Bashkisë së Devollit, z. Eduart Duro, Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli, Myftiu i Pogradecit, z. Namik Mahmutllari, Myftiu i Devollit, z. Edmond Ceni.

Këto workshope u zhvilluan në Pogradec dhe në Bilisht.

Menaxhimi i këtij projekti nga ana e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë bëhet nëpërmjet, z. Fezi Shaholli, Drejtori i Marrëdhënieve me Jashtë.





5

MBLIDHET KËSHILLI I PËRGJITHSHËM I KMSH-SË

Këshilli i Përgjithshëm i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë u mbledh me datë 22. 05. 2021, në ambientet e Medresesë së Tiranës, ku u zhvillua mbledhja e zakonshme pas një kohe të gjatë shkëputjeje për shkak të pandemisë Covid-19.

Takimi u hap me leximin e disa ajeteve kur'anore nga Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli, për të vijuar më tej me fjalën hapëse të kancelarit të KMSH-së, z. Ylli Cikalleshi, i cili bëri një përmbledhje të raporteve dhe vendimeve të marra që nga mbledhja e fundit e këshillit.

Raporti pasqyroj gjendjen në lidhje me aspektin fetar, rritjen e pagave, aktivitetin e përfaqësimit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Kryetari në veçanti, dhe disa ndryshime statutoe që rrjedhin prej tyre.

Risia e kësaj mbledhje është prezantimi për herë të parë në historinë e KMSH-së, dixhitalizimi i pronave, nëpërmjet programit "E-Prona", program i cili do të rrisë transparencën, do të shkurtoj kohën, dhe, më e rëndësishmja, do të rrisë efikasitetin e pronave, rikthimin e tyre në rentabilitet të plotë dhe rrjedhimisht rritjen e aktivitetit fetar në vend.

Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, përshëndeti të gjithë anëtarët e këshillit të përgjithshëm, bëri një rezymë të përgjithshme të ecurisë dhe mbarëvajtjes së punëve gjatë dhe pas pandemisë, si dhe, shpjegoi si ndikoi ajo në aspektin fetar dhe ekonomik të KMSH-së.

Në këtë mbledhje u lanë edhe disa porosi e prioritete për të ardhmen, për të bërë të mundur që institucioni i KMSH-së të jetë në nivelet më të larta të përfaqësimit dhe përgjegjësisë që mbart.

6

KRYETARI I KMSH-SË, H. BUJAR SPAHIU, PRITI PËR VIZITË NUNCIN APOSTOLIK NË SHQIPËRI, Z. LUIGI BONAZZI

Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, priti për vizitë Nuncin Apostolik në Shqipëri, z. Luigi Bonazzi.

Kryetari Spahiu vlerësoi marrëdhëniet e deritanishme miqësore dhe theksoi rëndësinë e kujdesin e vazhdueshëm që duhet të tregojmë për ruajtjen e tyre, të cilat, sipas tij, në kontekstin e harmonisë fetare në Shqipëri, shkojnë përtej përkatësive fetare, me qëllim ruajtjen e paqes dhe kohezionit social.

Nunci Apostolik falënderoi z. Spahiu për mikpritjen dhe çmoi shumë angazhimin dhe përkujdesjen e veçantë që tregon ai si drejtuesi më i lartë i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për dialogun dhe harmoninë në vend.

Gjatë bisedës u fol edhe rreth "Konferencës Globale të Vëllazërisë Njerëzore" dhe dokumentit të përbashkët të dalë nga kjo konferencë, nënshkruar ndër të tjerë edhe nga, Shejhul Al-Az-harî, Shejh Ahmed al-Tajjib dhe Papa Françeskut.



Për çfarë kemi nevojë (1)

Periudha kohore që jetojmë ka sfidat e veta. Për më tepër, çdo periudhë kohore nuk mund të kuptohet pa sfida e vështirësi. Të ëndërrosh se do të vijë një ditë në të cilën nuk do të kesh asnjë vështirësi në rrugën e jetës nuk është aspak gjë e mirë. Do të ndodhin ngjarje që as që i ke menduar se do të ishin pjesë e jetës dhe mund të pësosh zhgënjime të rënda. Zhgënjimet me siguri që do të të turbullojnë shpirtin dhe zemrën. Me rëndësi është që të mos turbullohemi aq shumë, sa që të mos dallojmë të mirën nga e keqja, të drejtën nga e padrejta, të bukurën nga e shëmtuara. Nëse mbërrijmë në këtë gjendje është koha për një operacion të thellë brenda vetes, që të pastrojmë papastërtitë që na kanë mbuluar zemrën, na kanë dobësuar dëgjimin dhe na kanë veshur shikimin.

Ecja në rrugën e pastrimit të vetvetes dhe ngjitjes së vazhdueshme në lartësitë e virtyteve ka nevojë për shenja; shenja që tregojnë qartë rrugën që duhet ndjekur, por edhe rrugët nga nuk duhet ecur.

1) Sinqeriteti

Baza e të jetuarit virtytshëm. Themeli pa të cilin humbet dhe fytyrën me të cilën vjen në ekzistencë. Të qenët i sinqertë është jetik. Pa sinqeritet çdo fjalë e thënë e çdo punë e kryer nuk ka vlerë. Humbin si nisia (ishulli) në oqean. Vlera nuk lidhet domosdoshmërisht vetëm me vlerën monetare. Të jesh i sinqertë do të thotë të jetosh me vërtetësi e drejtësi, pa e ndotur qëllimin në thellësi të zemrës me interesa materiale. Të zbatosh drejtësinë, të duash të bukurën, të jetësosh mirësinë, duke mos cenuar aspak hakun e njerëzve, janë shenja të sinqeritetit që gjallon zemrën. Të jesh i sinqertë nuk do të thotë të tregohesh naiv e të besosh se të gjithë janë të njëjtë si ty. Nëse kalon në këtë gjendje me siguri që do të nëpërkëmbesh prej atyre që i bëjnë llogaritë ndryshe. I sinqerti mbron principin dhe është i paepur përballë çdokujt që sinqeritetin e ka vetëm te fjala e thënë, ose justifikimet që përdor për të mos u ndjerë përgjegjës për fjalën e thënë dhe veprën e kryer.

2) Dituria

Njeriu diferencohet në hierarkinë e krijesave në sajë të aftësisë që i është dhënë për të mësuar, për të marrë dituri dhe për të jetuar me dinjitet sipas diturisë që zotëron. Të diturit kanë jetuar dinjitetshëm edhe kur varfëria ka qenë pasuria e tyre e vetme. Dija e lartëson njeriun. Nëse sinqeriteti është themeli i kërkimit të diturisë, atëherë gjurmët e të diturve nuk i fshin asnjë periudhë historike. Ata ose ato do të mbeten mes njerëzve derisa të ketë jetë mbi tokë. Njeriu nuk mund të bëhet i ditur brenda natës. Dija kërkon kohë, punë, përkushtim dhe sakrificë. Të marrësh dhe të japësh dituri nuk është vepër që realizohet vetëm në auditorë. Mundësitë e njeriut për të mësuar janë të panumërta. Çdo dituri që i shërben njeriut, për të jetuar me drejtësi e mirësi, është domosdoshmëri jetësore, është si ajri që thithim. Dituritë e çfarëdolloj fushe duhen studiuar, përvetësuar e zbatuar sipas natyrave dhe prirjeve që ka secili nxënës e student. Edhe profesioni më i rëndomtë ka nevojë për dituri që të realizohet me përgjegjshmëri dhe në përputhje me rregullat morale e etike. Prandaj nuk duhet hequr dorë nga studimi i disiplinave të ndryshme shkencore, nga përvetësimi i aftësive në profesione të ndryshme, përderisa janë rrugë që sigurojnë të ardhura dhe prej këtyre të ardhurave përmbush detyrimet ndaj vetes, familjes e më gjerë. Nuk kemi pse stepemi, pse të dyshojmë te vetet tona nëse jemi apo jo në udhën e duhur kur studiojmë disiplina shkencore të quajtura gabimisht si dituri vetëm të kësaj bote. As nuk kemi pse të heqim dorë prej këtyre diturive me frikën se do të humbim udhën e do të hyjmë në rrugica pa krye. Dituritë që mësojmë duhet t'i kalojmë në sitën e moralit dhe etikës. Nuk mund të përdoren dituritë e mësuara për të dëmtuar njerëzit. Dëmi më i madh që mund t'u bësh njerëzve është topitja e fuqive të tyre menduese, analizuese e kritike. Kjo topitje, ku me frikë e ku me stërmëbushje të stomakut, sjell degradimin e mendjes njerëzore, që mund të manipulohet lehtësisht dhe të përdoret në funksion të përmbushjes së interesave të caktuara, pa lidhje me principet themelore. Çdo lloj manipulimi është kundër principeve, sepse manipulimi zhduk lirinë. Ndërkohë pa liri nuk ka as jetë mbi bazë principesh.

Shpirti i civilizimit ISLAM

"Industria e rëndë", të cilën thirrja islame e ngriti qysh prej periudhës së Mekës, ishte, padyshim, industria e formimit islam ndaj njeriut që përqafon Fenë Islame. 'Shtëpia e Erkam Bin Erkam' në periudhën kur thirrja islame mbahej e fshehtë, domethënë qysh prej fillimit të asaj thirrjeje, ishte e para e institucioneve edukative, të cilën e ngriti Profeti i Islamit, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të.

Para se myslimanët të pushtonin qytetet dhe vendet, si dhe para ngritjes së shtetit, ndryshimit të realitetit, zbatimit të ligjit dhe kristalizimit të marrëdhënieve ndërkombëtare, ishte pushtimi islam i zemrave dhe i mendjeve nga udhëzimi i Kur'anit Fisnik. Ai udhëzim u bë morali, sjellja, praktika dhe karakteristika e jetës që jetojnë myslimanët. Madje, të parin prej qyteteve që çliruan myslimanët, para Hixhretit Profetik dhe para shtetit islam -që ishte Medina-, ata e çliruan me Kur'anin Fisnik.

Pas realizimit të formimit Islam të njeriut -nëpërmjet edukimit-, erdhën të gjitha arritjet dhe sukseset në fushat e civilizimit dhe të shkencave të tij, dhe të kulturës me etikën dhe artin e saj, si mishërim i asaj që parapriu dhe u realizua në personin e njeriut. Të gjitha ato erdhën të përpiluara me kriteret islame, të cilat paraprinë dhe projektuan personat, mendjet dhe zemrat e atyre që u udhëzuan me Udhëzimin e Kur'anit. Thirrja fetare në Islam nuk ndaloi te limitet e përqafimit të fesë nga ana e njeriut dhe të përmbushjes së adhurimit ndaj Allahut, nëpërmjet riteve që shprehin besimin e zemrës dhe që deklarojnë qartë lidhjen e tij

me qiellin, por kjo thirrje u zgjerua dhe u shtri për të realizuar koalicionin e njeriut me umetin, me shoqërinë dhe me universin. Kështu, në personalitetin e këtij njeriu u bënë bashkë Botët e të Padukshmes dhe të Dukshmes. Tek ai u bashkuan dhe u ekuilibruan lidhjet e individit me shoqërinë; e veçanta me të përgjithshmen. Dynjaja u bë më fetare, por duke mbetur po dynja, në momentin kur Islami i dha formim personit të njeriut mysliman, ndërgjegjes dhe mendjes së tij, atë formim në të cilin u bënë bashkë dhe u ekuilibruan ajetetet e Allahut në Shpalljen Qiellore me ajetet -shenjat- e Tij tek individët dhe horizontet.

Feja Islame nuk ngrihet dhe nuk ndërtohet as mbi beqarinë individuale dhe as mbi shpëtimin personal, por ajo, për ngritjen e saj dhe për realizimin e plotë të të gjitha detyrimeve të saja, kërkon, medoemos, umet, atdhe, bashkim, shoqëri dhe detyrime sociale tek të cilat të orientohet adresimi dhe nëpërmjet tyre të detyrohet umeti. Këto detyrime shoqërore janë më të rëndësishme dhe më të sigurta se sa detyrimet individuale, me argumentin se, mëkati i mosplotësimit të detyrimit individual bie mbi vetë individin, kurse mëkati i mosplotësimit të detyrimit shoqëror bie mbi të gjithë umetin.

Në fenë islame, Hixhreti -Emigrimi- në Rugën e Allahut u bashkëshoqërua me ngritjen e shtetit e të shoqërisë dhe me zbatimin e ligjit. Ngritja e strukturës shoqërore mes nënshtetasve bën realitet arritjen e vëllazërisë, jo thjesht në të drejtat fetare, por, gjithashtu, edhe në çështjet e jetës. Madje kjo strukturë është shtrirë

në kriteret e qytetarisë e të kombësisë; madje deri te kundërshtimi në fe, saqë kjo strukturë i përfshiu bashkë jomyslimanët me myslimanët. Kështu, Hixhreti nuk është murgëri, që me të dhe nëpërmjet saj të arrihet pastrimi, me anë të mbylljes dhe veçimit nga jeta e njerëzit, por murgëria e umetit islam është xihadi, i cili është një detyrë shoqërore, që e bën të domosdoshme ekzistencën e umetit, atdheut dhe shoqërisë.

Thirrja fetare islame ka përfunduar te rezultati i formimit edukativ te personaliteti i individit mysliman, i cili u bë një faktor psikologjik dhe realizoi bashkimin e elementeve individualë në shoqërinë islame, prej elementeve natyrorë e ligjorë, prej atyre civilizues e fetarë, prej atyre logjikë dhe të njohurisë së transmetuar dhe prej atyre materialë e të thjeshtë. Ai koalicion ishte një civilizim islam që e solli njeriut, të cilin e formoi thirrja islame, dhe ajo është një veçori prej veçorive të fesë islame dhe të civilizimit islam. Mesazhet fetare, që paraprinë mesazhin përfundimtar të Islamit, ose ishin në sinkroni me civilizime jofetare dhe bashkëjetuan me to, duke mos i ndryshuar ato dhe duke mos i ngjyrosur me ngjyrimin e tyre, për shkak se ato mesazhe qëndruan thjesht te limitet e fesë, ose ato civilizime, të cilat paraprinë civilizimin islam, jetuan në kohët e periudhës 'El-Fitretu', e cila nuk pati mesazhe qiellore.

Dallimi i Islamit është se ai solli qytetërim, formoi civilizim, ngriti shoqëri njerëzore dhe vendosi në mënyrë sintetike, në personin e njeriut -nëpërmjet metodologjisë së edukimit të gjithanshëm-, atë koalicion të ekuilibruar, që e bëri këtë njeri të sjellë një civilizim artificial me ngjyrimin e fesë. Feja Islame, sigurisht, realizoi koalicionin, ekuilibrin dhe sigurinë te vetë personi i njeriut mysliman. Kështu, krijimi civilizues i këtij njeriu -domethënë civilizimi islam- erdhi si një fryt i mishëruar i kësaj që e prodhoi feja në personin e këtij njeriu. Mirëpo, kur ky civilizim dhe kultura e tij kaluan dhe u larguan prej këtij ngjyrimi, ndodhi ky defekt të cilin ne po e vuajmë sot, dhe i cili ndodhi qysh prej disa shekujsh, dhe për kurimin e sëmundjes së të cilit japin ilaçe të gjitha thirrjet dhe lëvizjet reformatore në umetin e Islamit.

Në qoftë se Islami ishte shkaku i përparimit të myslimanëve për ngritjen civilizuese të tyre dhe për lulëzimin kulturor të tyre, atëherë cili është shkaku i prapambetjes që i goditi myslimanët, pavarësisht vazhdimësisë së Islamit në po atë gjendje, ashtu siç ishte atëherë kur bëri të vërshonin burimet e përparimit në jetën islame? Shkaku, sigurisht, është mungesa e 'shpirtit' (mungesa e shpirtit islam) në civilizim (në civilizimin islam). Është ndërprerja e lidhjes mes Islamit dhe civilizimit të myslimanëve. Ky shpirt, bëri të mundur që civilizimi të bëhej islam, madje atë të cilin e bëri të vërshonte dhe që e ngjyrosi me ngjyrimin e Islamit.

Hasan Basriu, në një rast, u ul pranë një predikuesi, por zemra e tij nuk u ndikua nga predikimi i tij. Hasani e pyeti atë: "O vëlla, a në zemrën tënde ka sëmundje apo në zemrën time?". Kështu, ndërprerja e lidhjes, si rrjedhojë e mungesës së shpirtit, është shkaku i sëmundjes dhe qorrrokaku i civilizimit, për të cilin kërkohet të jepen ilaçe kuruese prej shkollave të ndryshme reformatore. Cili është ky shpirt, i cili e bëri fenë islame -dhe jo fetë e tjera- të prodhonte civilizim e kulturë dhe i cili nuk qëndron thjesht te feja? Ku është vendi i defektit, i cili ka ndaluar aktivitetin islam në civilizim e kulturë, i cili e degradoi civilizimin islam dhe atrofizoi kulturën islame, pavarësisht vazhdimin të Islamit 'si Fe', ashtu siç është, dhe pavarësisht vazhdimin të besimit në të dhe kapjes pas lidhjeve të saja?!

Shejh Muhamed el-Fadil bin A'shur, kur diskutoi rreth kësaj çështjeje boshtore, paraqiti pikat vijuese:

NGRITJA E CIVILIZIMIT DHE E KULTURËS

Dallimi i Islamit si "Fe" është nëpërmjet shfaqjes së civilizimit dhe ngritjes së kulturës. Nëse Islami, si fe, bashkohet me fetë e tjera në lidhje me ato çështje që janë tema të përgjithshme të feve, Islami, gjithashtu, ka aspekte me të cilat ai veçohet prej atyre feve, të cilat ndajnë me të çështjet fetare në mënyrë të përgjithshme. Kjo për arsye se Islami ka aspekte lidhjeje me kulturat dhe civilizimet, gjë të cilën nuk e kanë fetë e tjera. Ai që ne e quajmë 'Civilizimi Islam', ose ajo të cilën ne e quajmë 'Kultura Islame', janë një varg ngjarjesh, situatash dhe rrethanash shoqërore dhe intelektuale, për të cilat Islami ishte baza e shfaqjes së tyre dhe shkaku i formimit të tyre. Islami nuk ndaloi te bashkëjetesa me shkencën, por çdo çështje shkencore u bë e lidhur me besimin fetar, duke u bërë një lidhje midis fesë dhe njohjes intelektuale, ose midis shkencës së natyrës dhe asaj prapa së cilës ekziston lidhja e ndërveprimit dhe ndërthurjes. Nga kjo u shfaq orientimi drejt jetës dhe sjellja me të, ku faktori i besimit fetar është shtytësi në të gjitha aspektet e tij. Shtytësi fetar u manifestua në ngritjen e dijetarit, në produktin e letrarit dhe në formimin e artistit. Njohja shkencore u bë themeli i fjalës së folësit, i fikhut të fekihut-juristit, i tesavufit të sufiut-mistikut dhe i mënyrës që i lidh elementet e njohjes. Ajo nxori librat e akides islame, duke grumbulluar njohuritë rreth natyrës, matematikës dhe humanizmit së bashku me të vërtetat e besimit. Shkenca dhe feja bëhen të njëtrajtshme dhe të pajtueshme në të dhe, tek ajo, e logjikshmja dhe njohuria e transmetuar mbështesin njëra-tjetrën.

Shoqëria Islame u formua menjëherë pas thirrjes fetare. Ajo është një shoqëri fetare me kuptimin e saj më të veçantë. Feja ishte faktori i parë i drejtpërdrejtë në të. Prej thirrjes së fesë dhe besimit tek ajo, populli, i cili iu përgjigj asaj thirrjeje dhe u dallua me atë besim,

fitoi tipare të reja shpirtërore. Perceptimet fetare ishin pikërisht ato të cilat i hapën horizontet e gjithësisë para shikimit të myslimanit për shqyrtim, meditim, njohje e besim. Kështu, e vërteta e besimit në Zot është themeli i gjithçkaje, prej strukturave konkrete dhe abstrakte, që ngriti civilizimi islam. Njeriu i këtij civilizimi, nëpërmjet fesë ideoi, nëpërmjet fesë ai prodhoi veprat e civilizimit të tij dhe nëpërmjet fesë ai ngriti shtetin e drejtë dhe civilizimin e tij. Gjithashtu nëpërmjet fesë vazhduan aspektet e civilizimit, duke mbetur tek ai të lidhura me fenë, dhe faktorët e fesë kanë shumë ndikim në aspektet e civilizimit.

EKUILIBRI DHE HARMONIA

Gjithashtu, ky civilizim islam dhe kultura e tij u dalluan me ekuilibrin dhe harmoninë, sepse ato janë rezultati i dallimit të Islamit, i cili bëri realitet integritetin, ekuilibrin dhe harmoninë në burimet e njohjes njerëzore. Të vërtetat që lidhen me materien dhe me ato që gjenden përtej saj janë në rrezën e veprimit të njeriut. Ai mund të arrijë tek ato nëpërmjet perceptimeve të tij të shumta, të klasifikuara e të theksuara, të cilat e mbështesin njëra-tjetrën pa tëhuajtje, pa grindje dhe pa kokëfortësi. Shqisat instiktive kanë nga pas shqisat e perceptimit; pastaj shqisat e perceptimit kanë nga pas perceptimet logjike; pastaj perceptimet logjike çojnë te parathëniet përcuese për të marrë perceptimet e të Padukshmes, të cilat vijnë nëpërmjet Vahjit- Shpalljes-, e deri te pranimit dhe nënshtrimit. Gjithashtu, këto perceptime mbeten vazhdimisht duke ndihmuar e mbështetur njëra-tjetrën. Nuk mund të përfitohet, nëpërmjet një rruge të vetme prej tyre, ajo që bie në kundërshtim me rezultatin prej rrugës së një perceptimi tjetër, por, megjithatë, nëse dikush është i pamundur ta ngërthejë njëren prej atyre dy rrugëve, mund të lidhet me një rrugë tjetër prej tyre, derisa të përfundojë te bindja dhe nënshtrimi që fitohen nëpërmjet të jashtëzakonshmes, e cila është Ruga e Vahjit- Shpalljes. Kështu, mendja e njeriut dhe besimi i tij, perceptimi i tij lëndor dhe ndjenjat e tij instiktive, që të gjitha janë të harmonizuara dhe bashkëpunuese me njëra-tjetrën. Ato nuk kanë frikë nga njëra-tjetra dhe asnjëra prej tyre nuk e pret rrugën e tjetrës. Civilizimi Islam ishte gjurmë e një njeriu, i cili fitoi një gjendje të harmonizuar e të ekuilibruar në vetvete dhe duke qenë i sigurt në vetvete. Ai, bazuar në modelin e vetvetes, ndërtoi një civilizim që e bëri të fitonte atë çfarë ai fitoi. Ai i dha atij civilizimi nga ajo që Allahu i dha atij, derisa ai civilizim u ngrit me atë harmoni, ndryshe nga civilizimet e tjerë.

CILAT ISHIN SHKAQET E PRAPAMBETJES?

Por çfarë ndodhi që civilizimi islam mbeti prapa dhe kultura e tij u atrofizua, pavarësisht vazhdim

të Islamit, i cili i prodhoi ato dhe realizoi lulëzimin e tyre që zgjati për disa shekuj dhe ato të dyja ishin një fanar ndriçues për botët? Nuk qe Islami ai që u goditi, por ishin kultura dhe civilizimi islam. Ato të dyja aspironin Islamin, mallëngjeheshin për të dhe shpresonin shërimin e tyre tek ai. I afërti dhe i largëti e kuptonin se ajo që i ra shoqërisë islame në civilizimin dhe në kulturën e saj nuk ishte asgjë tjetër përveçse shmangies prej origjinës, ndryshimit të situatës dhe ikjes prej faktorit edukativ themelor, i cili obligon kapjen pas bazave dhe që konsolidon e sundon situatat. Ajo që goditi civilizimin dhe kulturën e shkëputi vërtetësinë e kërkimit të ndihmës prej Islamit dhe të mbështetjes së fortë tek ai, saqë kolonat bazë të tij anuan dhe u shembën. Defekti nuk ndodhi te vetë Islami, por u ndal besimi se Islami ishte shpirti i civilizimit. Dëshira e besimit konstruktiv për civilizim u tërhoq e u veni. Ndodhi ftohja civilizuese prej fetares dhe ndarja e fesë prej dynjasë.

Shpjegimi i aspektit, të cilin e goditi sëmundja në akide, është pikërisht ai që i zbulon shkaqet të cilat i dhanë goditje civilizimit, duke e dobësuar atë dhe duke e atrofizuar. Ajo që ndodhi në akiden islame dhe që shkaktoi rënien e civilizimit ishte ftohja që e largoi shpirtin e saj prej civilizimit dhe, kështu, civilizimi u bë i ngatërruar dhe i pajetë, duke mos përparuar. Ajo ftohje ishte vetëm njëra prej pasojave të dobësisë e cila e goditi akiden në thelbin e saj. Edhe dëshira e besimit konstruktiv u dobësua dhe u lëngua. Rrethanat shoqërore dhe veprat e civilizimit u bënë të shfaqeshin jo më ashtu siç dukeshin më parë nga akideja. Kjo bëri të mundur që civilizimi të shfaqej në një luginë, ndërsa akideja në një luginë tjetër. Myslimani vazhdoi që qëndronte besnik ndaj besimit të tij fetar si dhe ishte xheloz e i zellshëm për të, nga një aspekt, duke pranuar jetën e tij praktike, dhe duke qenë i qetë për realitetin e saj nga një aspekt tjetër. Kështu, parimi teorik dhe realiteti praktik u bënë të dallueshëm qartë tek ai, dhe prej kësaj lindën teoria e ndarjes së fesë nga dynjaja, duke e konsideruar fenë një të mirë joreale dhe duke e konsideruar dynjanë si një të keqe reale, dhe se adhuresi mysliman mban midis kraharorit të tij një fe që nuk ka ndikim veçse rrallë dhe se ai jeton në dynja duke mos njohur në të veçse ato gjëra që e largojnë nga feja. Pastaj, në jetën e tij praktike, atë e sulmuan civilizime të huaja për të, në të cilat ndodhen shkenca, industria, fuqia dhe urtësia. Ai nuk gjeti prej dëshirës së tij fetare atë çfarë ofroi për të ky civilizim. Ashtu siç ofruan civilizimet të cilat qenë në kontakt me to më parë, në ditën kur dëshira e tij fetare ishte e fuqishme dhe e shëndetshme, dhe qëndroi para saj i ngrirë e i palëvizshëm, duke e konsideruar atë si një tërësi e mënyrave të jetës

që ishin më parë dhe besoi ndarjen e tyre nga feja." Ky është pikërisht defekti, të cilin Ibn Halduni e perceptoi dhe e analizoi më mirë se kushdo tjetër. Ibn Halduni e analizoi çështjen në mënyrë të hollësishme, kur i bëri çështjet politike, ato të zhvillimit, të industrisë dhe të shkencës në shtetin islam, të varura nga çështja e fesë, duke e bërë atë të vërtetën parësore. Ai e bëri atë që është akideja individuale bazën dhe themelin e të gjithë asaj. Ai nisi të studionte problemin e korrupsionit të shtetit dhe amullinë e zhvillimit -në shekujt e mëvonshëm të Islamit prej shekujve të tij të mëparshëm- uljen e prodhimeve, ikjen e talenteve të shkencave, mangësinë e mënyrave të mësimdhënies në qytetet islame të kohës së tij, duke e bërë të gjithë këtë t'i referohej defektit të së vërtetës parësore të fesë, e cila është themeli i zhvillimit që shfaqet me të dhe i shtetit të ngritur mbi të, dua të them akiden fetare, duke e kthyer të gjithë atë te mënyra e formimit të individit me formim fetar, që lidhet nga një aspekt me fenë islame, me akiden e saj, dhe kalon prej saj për te çdo gjë që buron prej asaj akideje prej fenomeneve të zhvillimit, industrisë dhe të mendimit. Në qoftë se njerëzit qenë të kënaqur të njësoheshin me defektin që u shfaq në shoqërinë islame dhe me civilizimin e saj, gjë e cila u referohet sistemeve të qeverisjes dhe formave të shtetit, si dhe prej asaj që u përhap prej prishjes së moralit dhe prej këputjes së lidhjeve shoqërore, Ibn Halduni kërkon shkaqe për këto sëmundje, duke ua referuar këto shkaqeve të tyre. Atëherë, transformimi i kalifatit në sundim nuk është një sëmundje por një shkak sëmundjeje që e ndryshoi sanksionin fetar në synime për të sunduar e mposhtur, në kthim në epshe e dëfrime dhe në sjelljen e frymës së shtetit në vend të frymës së fesë. Ibn Halduni e ktheu civilizimin islam tek origjina dhe te baza e tij, ose më qartë, te shpirti i tij që është Akideja Islame.

MADHËSIA E PROBLEMIT

Në qoftë se ky është problemi, atëherë cila është madhësia e tij? Cila është jeta e tij? Madhësia e këtij problemi nuk është e vogël dhe jeta e tij nuk është e shkurtër. Në qoftë se ne nuk e mohojmë se civilizimi islam u tkurr, mbeti prapa dhe u shkëput, se kultura u atrofizua, u ftoh, u venit dhe gati u bë gërmadhë, se ajo nuk është foshnja e djeshme dhe as e djeshmja e saj, por ishin sëmundjet që u bënë të rënda në shekujt e fundit sa që u bë i vështirë shërimi i tyre; pastaj ato vazhduan të shumohen e përkeqësohen dhe dhimbjet dhe rreziqet e tyre u rënduan derisa kanë mbërritur në këtë situatë të frikshme, sa që shekulli ynë po ankohet në mënyrë shumë të zhurmshme. Cila është zgjidhja? Në përfundim dhe pasi përkufizuam shpirtin e civilizimit islam dhe pasi diagnostikuam sëmundjen

-defektin- që goditi civilizimin dhe kulturën tonë, atëherë cila është zgjidhja reale e këtij problemi? Cila është dalja prej këtij qorrrokaku, që po ngushton lakun e këtij Umeti dhe që po i zë frymën? Zgjidhja është kthimi te shpirti i cili prodhoi civilizimin e lulëzuar dhe kulturën e shndritshme. Është kthimi i shpirtit fetar, që t'i japë formë rizgjimit të dalluar të së ardhmes. Ky është kuptimi i vërtetë i thënies: "Nuk do të rregullohet fundi i këtij Umeti veçse me atë që u rregullua fillimi i tij." Në qoftë se nuk do të ishin formimi individual Mekas dhe formimi kolektiv Medinas, nuk do të ishin veprat e civilizimit që u shfaqën në kryeqytetet e Islamit. Në qoftë se njerëzit sot mallëngjehen për periudhat e arta, në të cilat ato lulëzuan në ato kryeqytete, dhe digjen nga malli për t'i rigjallëruar e ripërtërirë ato, atëherë sa e përshtatshme do të ishte për ata që t'i kthehen faktorit bazë, i cili i prodhoi ato periudha të arta, ai faktor pa të cilin nuk do të kthehet lulëzimi i atyre shekujve dhe pjekuria e tyre. Ai është faktori edukativ islam, i cili formoi individin para se të formonte shoqërinë, dhe shtroi rrugën për kulturën para se të merrte elementet e njohjes, të cilat formuan entitetin e saj. Ndërsa në qoftë se ne do të qëndronim te 'pavarësia e flamurit dhe e himnit' pa të vërtetat e 'pavarësisë civilizuese', që është fryti i ngjyimit të dalluar islam, ne nuk do të mund të dalim prej qorrrokakut në të cilin jetojmë sot.

Bota Islame ka dalë prej sundimit të të tjerëve dhe ka rikthyer sovranitetin e saj, por a mundet ajo që ta rikthejë civilizimin e saj dhe t'i marrë përsëri peshat dhe përgjegjësitë, duke paraqitur për njerëzit një formë të re kulture dhe civilizimi të stampuar me stampën e personalitetit të saj islam dhe të shfaqur prej parimeve të Akides Islame, prej së cilës buroi forma e së shkuarës, gjë të cilën e njohu historia prej kulturës së Islamit dhe civilizimit të tij?

Rilindja e Japonisë nuk është budizmi; as rilindja e Kinës nuk është rilindja e konfucianizmit; as rilindja e Greqisë nuk është bizantinizmi, as platonizmi, as aristotelizmi dhe, ajo nuk është as greqizmi në ndonjë mënyrë. A do të ishte e kufizuar çështja e Islamit në këtë gjendje? Apo civilizimi islam, shpirti dhe kultura islame, do të jetë stampa që do të duket mes asaj sasi të përbashkët të përbërë midis popujve të Umetit Islam, që do të rizgjohej në të ardhmen? Ai shpirt i atij civilizimi është vendi kryesor i problemit.

Këto ishin disa prej çështjeve, ideve dhe boshteve të ndërlukuara rreth të cilave janë ngatërruar reformatorët. Shpirti i civilizimit islam, i cili e prodhoi dhe e dalloj civilizimin dhe kulturën në shekujt e fillimit dhe të lulëzimit. Vendi i defektit që e bëri civilizimin të mbetej prapa dhe që atrofizoi kulturën. Zgjidhja dhe dalja prej këtij qorrrokaku civilizues në të cilin jeton sot Umeti islam.

Shqipëroi nga Arabishtja: Jusuf Salkurti

MBROJTJA PËR TË DOBËTIT DHE TË PRIVUARIT NGA E DREJTA ËSHTË CILËSI E NJERËZVE TË MËDHENJ DHE FISNIKË

Abdullah bin Haram r.a., vdiq si shehid në luftën e Uhudit, por i kishte mbetur borxh tridhjetë barrë hurma jehudiut me emrin Ebu Shahm. Djali i tij, Xhabir bin Abdullahu r.a., deshi që ta kthejë borxhin e babait, por kur shikoi kopshtin e hurmave, kuptoi se hurmat nuk do mjaftonin për ta paguar borxhin. Për këtë, shkoi tek Ebu Shahmi dhe e luti që t'ia shtynte afatin e borxhit, por ai e refuzoi këtë.

Xhabiri shkoi tek i Dërguari i Allahut a.s., duke kërkuar që të ndërmjetësojë për të tek Ebu Shahmi që t'ia shtyjë afatin e borxhit. I Dërguari i Allahut a.s., shkoi tek Ebu Shahmi dhe i tha: "Shtyja afatin e borxhit Xhabirit." Mirëpo, ai e refuzoi ndërmjetësimin e Pejgamberit a.s.

Pas kësaj, i Dërguari i Allahut a.s., hyri në kopshtin e Xhabirit dhe eci mes drurëve të palmave, duke iu lutur Allahut, xh.sh., që t'i japë bereqet, e pastaj doli nga kopshti dhe i tha Xhabirit: "Shko vjel fruta hurmash aq sa nevojitet që ta kthesh borxhin." Xhabiri r.a., e dëgjoi të Dërguarin e Allahut a.s., hyri në palma për të vjelë hurma, por mbeti i habitur kur pa bereqetin dhe bekimin e Pejgamberit a.s., gjatë vizitës së kopshtit të tij. Kishte aq shumë hurma, sa që pasi e ktheu tërë borxhin, Xhabirit i mbeti gjysma nga sasia e tërë hurmave.

Xhabiri shkoi menjëherë për ta lajmëruar për këtë të Dërguarin e Allahut a.s., por e gjeti në namaz. Priti derisa e përfundoi namazin e pastaj i tregoi çfarë ndodhi me frutat e tij. Atëherë i Dërguari i Allahut a.s., tha: "Shko dhe lajmëroje Omer bin Hatabin për këtë."

Xhabiri shkoi dhe i tregoi Omerit r.a., për atë çfarë ndodhi me pemët e kopshtit të tij, ndërsa Omeri i tha: "E kam ditur

që kur i Dërguari i Allahut a.s., ecte nëpër kopsht, se do të lutej për zbritjen e bereqetit në frutat tua."

Siç dihet, Allahu i Madhërishëm shehidit ia falë të gjitha mëkatet, pos borxhit. Edhe pse Abdullah bin Haram, r.a., luftoi nën flamurin e të Dërguarit të Allahut a.s., dhe vdiq si shehid në Uhud, nga ai nuk ra obligimi i kthimit të borxhit, atëherë si të lirohet nga ky obligim dikush tjetër?

Nga ky hadith mësojmë se ndërmjetësimi për vëllain mysliman, që të realizojë të drejtën e tij, të kthejë borxhin, të mënjanojë brengën dhe pikëllimin, të zgjidhë problemin, është vepër e njerëzve të zgjedhur dhe fisnikë. E kush mund të jetë më fisnik se i Dërguari i Allahut a.s., të cilit nuk i erdhi rëndë dhe as turp si pejgamber dhe kryeshtetas që të ndërmjetësonte për Xhabir bin Abdullahun të jehudiut, dhe të qëndronte pranë tij derisa ta zgjidhte problemin.


Për këtë arsye, mos e anashkalo mirësinë e cila quhet ndërmjetësim, por përpiqu për të dobët, të varfrit dhe të privuarit nga e drejta, sa të jetë e mundur, por kujdes që ndërmjetësim yt të mos kthehet në zullum dhe nepotizëm, dhe të marrësh të drejtën e dikujt e t'ia japësh të drejtën atij që nuk i takon.

Nëse ndërmjetësimi yt refuzohet, mos e merr këtë si personale dhe mos heq dorë nga kjo formë e mirësisë dhe ndihmës së njerëzve, ngase edhe pse ndërmjetësimi i të Dërguarit të Allahut a.s., në këtë rast u refuzua, ai deri në fund të jetës nuk i ndali duke përpjekjet për të mbrojtur të dobët dhe të privuarit nga e drejta.

Përktheu: Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi







Kudsi,

KJO KUJTESË E HARRUAR

Kudsi i shenjtë. Ky vend i bekuar. Tokë e begatë, që soditet nga drita që vjen prej qiejve në qiell. Kudsi është vendi ku njeriu udhëton në të shkuarën, drejt origjinës, për të njohur misteret e qenies së tij. Ai është një mishërim i njerëzve më të lartë që kjo tokë ka mëkuar. Është një gjurmë nga e shkuara pa të cilën e tashmja nuk ka kuptim. Kudsi ishte toka e fundit që do të prekte Profeti ynë, e më pas do të vazhdonte rrugëtimin e tij drejt qiejve, në udhëtimin e natës së Miraxhit. Çdo vend kishte një dritë me të cilën u ndriçua, por në një moment të gjithë Kudsin ndriçuan. Ai ishte vendi ku të gjithë profetët u bashkuan. Me prijës Muhamed Musatafanë a.s Allahut iu nënshtruan. Kudsi. Kibla jonë e parë. Miku i shtrenjtë i Mekës për të cilën aq shumë përmalohet. Sa shumë e kemi harruar. Në sirtarët e historisë e kemi braktisur.

Kudsi. Ky vend i qetësisë dhe i sigurisë së shpirtit. Ky vend i përbashkët i njerëzimit, prej të cilit shumë janë ndarë. Njëri-tjetrin kanë luftuar. Për këtë vend të shenjtë, për të cilin duheshin bashkuar. Ky është paradoksi më i madh i njeriut me veten e tij. Konflikti i njeriut me të shkuarën dhe identitetin e tij. Ato gurë të moçëm, që lartësimin e Zotit, përmallimin dhe lotët e njerëzve dëgjojnë, bashkë me to i përjetonin, e sot të trishtuar në kurbet jetojnë. Kudsi. Ky vend i shenjtë. Si i tillë, vetëm ata që të shenjtën kërkojnë e meritojnë. Vetëm ata me të mund të flasin dhe misteret e tij të përjetojnë. Kudsi. Kjo parajsë në tokë. Pret të zbulohet, që në begatinë e tij paqe dhe qetësi të na kaplojë. Prandaj të kthjellohemi. Të pastrojmë zemrën tonë nga pasionet e kësaj bote. E më pas për në Kuds të nisim rrugëtimin. Për tu kthyer atje, në shtëpinë tonë të vjetër. Në zanafillën tonë.

Ebu Hurejra

NGA JETA E NJË TRANSMETUESI TË DASHUR

"An Ebi Hurejre radijAllahu anhu kal, kale Resul Allahi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem...."(Mbështetur në autoritetin e Ebu Hurejres, Allahu qoftë i kënaqur me të, se i dërguari i Allahut, paqja qoftë mbi të, ka thënë)

Vargu i parë i një kënge, i një poezie që buzët e miliona myslimanëve e recitojnë plot respekt, që veshët e miliona besimtarëve e dëgjojnë e sytë e miliona të devotshmëve e lexojnë plot përkushtim prej më se njëmijë e katërqind vjetësh! Sa e sa prej nesh janë tashmë të familjarizuar me këtë refren që na ka bërë të njohur emrin e Ebu Hurejres, të cilin e shohim, gjithashtu, të përmendur në të gjitha veprat e hadithit, historisë profetike e jurisprudencës islame.

Ebu Hurejra ishte një njeri i talentuar, që Zoti i kishte dhënë aftësinë e jashtëzakonshme të të ruajturit në kujtesë dhe të të riprodhuarit edhe vite më vonë, pa ndryshuar as edhe një fjalë e me përpikërinë më të madhe, të çdo bisede a ligjërate të dëgjuar. Duke dashur të shfrytëzojnë këtë aftësi të tij, pati njerëz që u përpoqën, duke përdorur emrin e tij, t'i atribuonin profetit të dashur, Muhamedit a.s. një numër hadithesh e fjalësh të pathëna kurrë prej tij, por përpjekjet mbinjerëzore e deri vetësakrifikimi i shumë dijetarëve e eruditëve të kohës bëri që hadithet e Profetit të dashur, të transmetuara nga Ebu Hurejra, të ruhen të pastra e të pacenuara. Ebu Hurejra u bë mysliman në prani të Tufejl bin Amrit, kryetarit të fisit që i përkiste. Pasi deklaroi besnikëri ndaj Islamit, ai e shoqëroi Tufejlin për në Mekë, ku pati nderin të takohet me Profetin. I dërguari i Zotit e pyeti se si quhej. "Abdu-Shems" (Shërbëtor i Diellit), u përgjigj Ebu Hurejra. Atëherë Profeti i kërkoi që



ai ta ndryshonte emrin në "Abdur-Rahman" (Shërbëtor i të Gjithëmëshirshmit). Megjithatë ai vazhdoi të njihej mes njerëzve me emrin "Ebu Hurejre" (Njeriu i maces) për shkak të dashurisë që ai tregonte për një mace, të cilën e përkëdhelte, e ushqente dhe e cila e ndiqte pas kudo. Ebu Hurejra jetonte me të ëmën, e cila ishte ende politeiste. Ai lutej për të dhe përpiquej që ajo të pranonte Islamin, por ajo refuzonte. Një ditë, ndërsa ai mendohej t'i shpjegonte asaj diçka mbi Islamin, ajo u mërzi dhe tha disa fjalë fyese për Profetin. Kjo e mërzi shumë Ebu Hurejren. Ai u nis te Profeti dhe, me sytë të mbushur me lot, i kërkoi që t'i lutej Allahut që nëna e tij të pranonte Islamin. Profeti ia plotësoi dëshirën dhe iu lut Allahut për nënën e tij. Kur Ebu Hurejra u kthye në shtëpi, ai nuk diti si ta shprehte gëzimin e tij kur mori vesh se nëna e tij ishte penduar për mëkatet dhe kishte deklaruar tashmë se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Tij. Pa ditur si ta shprehë lumturinë, ai doli me vrap nga shtëpia dhe rendi për te Profeti i dashur, i mbushur me gëzim, dhe e informoi atë se Allahu i ishte përgjigjur lutjeve të tij. Më pas i tha: "O i dërguar i Allahut, lutju Allahut që të na bëjë mua dhe nënën time të dashur për çdo besimtar e besimtare!" Dhe Profeti iu drejtua Allahut me lutjen: "O Zot, bëje këtë shërbëtor tëndin dhe nënën e tij besimtare të dashur për çdo besimtar e besimtare!" Me talentin dhe aftësitë e tij të jashtëzakonshme, Ebu Hurejra iu vu punës për t'i shërbyer me përkushtim fesë së tij. Duke parë shumë nga shokët e tij ishin të zënë me tregti e shumë miq të hershëm të tij, të pajisur me dituri, u vranë në luftëra, ai kuptoi se feja kishte nevojë për njerëz që t'i ruanin e transmetonin burimet e saj. Prandaj vendosi që ta shfrytëzojë kujtesën e tij të jashtëzakonshme duke qëndruar pranë Profetit e duke regjistruar thëniet e mësimet e tij mbi fenë. Për katër vjet me radhë, gjatë qëndrimit në Medinë, duke shfrytëzuar faktin se kishte shumë kohë të lirë (ai nuk merrej as me tregti, si mekasit, as me bujqësi, si ensarët) Ebu Hurejra nuk iu nda Profetit, duke u munduar që të dëgjonte e të përfitonte sa më shumë prej tij. Ai e donte shumë Profetin dhe nuk lodhej e nuk mërzi kurrë duke e dëgjuar atë. Shpesh ai do ta falënderonte Allahun për këtë fat të madh që pati me fjalët: "Lëvduar qoftë Allahu që e udhëzoi Ebu Hurejren për tek Islami! Lëvduar qoftë Allahu që i mësoi Ebu Hurejres Kur'anin! Lëvduar qoftë Allahu, që e nderoi Ebu Hurejren me shoqërinë e Muhamedit a.s.!" Për shkak të dashurisë së tij për dijen dhe shfrytëzimit të pjesës më të madhe të kohës për të qëndruar pranë Profetit, Ebu Hurejres iu desh që të kapërcente vështirësi të mëdha ekonomike. Ai tregon: "Një ditë uria m'u bë aq e tmerrshme, sa që m'u desh të vendos një gur mbi stomak. Më pas u ula anës udhës. Kur pashë Ebu Bekrin që po kalonte aty pari, i kërkova që të më sqaronte për një varg nga Libri i Allahut. Në fakt, e pyeta vetëm e vetëm që të

më ftonte për të ngrënë diçka..."

Krahas përkushtimit për të ruajtur fjalën e Zotit dhe mësimet Profetit, Ebu Hurejra nuk harronte t'i drejtohej shpesh Allahut me lutje e adhurim. Herë ai, herë e shoqja dhe herë e bija e tij luteshin me radhë netëve dhe kjo bënte që nata në shtëpinë e tij të mos kalonte thuajse asnjë çast pa lutje e adhurim ndaj Zotit të Lartësuar. Ebu Hurejra vazhdoi punën e tij në të transmetuarit e fjalës së Profetit dhe në të bërit të njohur të një numri të madh hadithesh. Megjithëse të njohur me aftësitë e tij memorizuese, shokët e tij shprehnin shpesh habi e admirim për gjithçka që ai kishte arritur të mësonte në një kohë aq të shkurtër. Gjatë kalifatit të Omerit (r.a.), ai u emërua guvernator i Bahrejnit. Aty ai u pasurua në një kohë të shpejtë. Omeri, si një njeri i ndjeshëm e i kujdesshëm, që kërkonte që guvernatorët e emëruar prej tij të jetonin thjeshtë dhe të mos siguronin pasuri të madhe qoftë edhe në rrugë të ligjshme, kur u informua për pasurinë e Ebu Hurejres, e thirri në Medinë dhe i kërkoi sqarime. Ebu Hurejra sqaroi se e kishte grumbulluar pasurinë e tij duke u kujdesur për kuajt, si dhe përmes dhuratave. Omeri i kërkoi që ai ta dorëzonte pasurinë e tij në thesarin e shtetit. Ebu Hurejra bëri si u urdhërua dhe ngriti duart nga qielli e u lut: "O Zot, fale prijësin e besimtarëve (Omerin)!" Më vonë Omeri e thirri përsëri Ebu Hurejren dhe i ofroi edhe një herë postin e guvernatorit të Bahrejnit, por ai nuk pranoi. I pyetur nga Omeri për arsyet e refuzimit, ai u përgjigj: "Sepse nuk dua që nderi im të merret nëpër këmbë, që të më merret pasuria e të më goditet kurrizi" Më pas shtoi: "Kam frikë se mos flas pa dije e gjykoj pa urtësi". Ebu Hurejra jetoi një jetë të ndershme, duke ia përkushtuar veten Islamit, duke qenë i sjellshëm e i mirë ndaj së ëmës dhe duke inkurajuar edhe të tjerët që të jenë të sjellshëm ndaj prindërve të tyre. Një ditë, kur panë se shëndeti i Ebu Hurejres ishte keqësuar dukshëm, miqtë e tij nisën të luten për shërimin e tij. Mirëpo ai hodhi vështrimin nga qielli e tha: "O Zot! Unë dua të të takoj Ty dhe shpresoj që edhe Ti të duash të më takosh mua!" Ai ndërroi jetë pasi e plotësoi detyrën dhe dëshirën e tij për të ruajtur e transmetuar mësimet e profetit të dashur, duke u lënë myslimanëve një pasuri të paçmueshme, bashkë me detyrimin moral për ta ruajtur e trashëguar edhe më tej atë pasuri. Ai mbetet një shembull i jashtëzakonshëm i dashurisë për diturinë e vetëmohimit për të. E ndërsa ne i lutemi Zotit të Lartësuar që ta shpërblejë Ebu Hurejren dhe t'i dhurojë atij edhe në jetën e amshuar miqësinë dhe shoqërinë e Profetit a.s., ashtu sikurse ia kishte dhuruar në këtë botë, në sytë, në buzët e në veshët tanë vazhdon të ndjehet ai refren që tashmë ka mbushur jetën tonë e është bërë kënga, poezia jonë e dashur prej shekujsh: "An Ebi Hurejre radijAllahu anhu kale, kale Resul Allahi, sal-lallahu alejhi ue sel-lem..."



Një histori e shkurtër e PALESTINËS

Palestina është një rajon i vogël i tokës, që ka luajtur një rol të shquar në historinë antike dhe moderne të Lindjes së Mesme. Historia e Palestinës është shënuar nga konflikte të shpeshta politike dhe konfiskime të dhunshme të tokave për shkak të rëndësisë së saj, si djep i disa religjioneve kryesore botërore dhe për shkak se Palestina qëndron në një udhëkryq të vlefshëm gjeografik mes Afrikës dhe Azisë. Sot, arabët, që e quajnë këtë territor si shtëpi, janë të njohur si palestinezë dhe populli i Palestinës ka një dëshirë të madhe për të krijuar një shtet të lirë dhe të pavarur në këtë rajon të kontestuar të botës.

ÇFARË ËSHTË PALESTINA?

Fjala Palestinë rrjedh nga fjala greke, Filistia, e cila daton në përshkrimet e shkrimtarëve antikë grekë për rajonin në shekullin e 12-të para Krishtit. Që nga rënia e Perandorisë Osmane në Luftën e Parë Botërore deri në

1948, Palestina zakonisht i referohej rajonit gjeografik të vendosur mes Detit Mesdhe dhe lumit Jordan. Pjesa më e madhe e kësaj toke tani konsiderohet Izraeli i sotëm.

Sot, Palestina teorikisht përfshin Bregun Perëndimor (një territor që ndodhet midis Izraelit të sotëm dhe Jordanisë) dhe Rripit të Gazës (e cila kufizohet me Izraelin dhe Egjiptin e sotëm). Rajoni (ose të paktën një pjesë e tij) njihet gjithashtu si Toka e Shenjtë dhe konsiderohet e shenjtë të hebrenjtë, të krishterët dhe myslimanët. Që nga shekulli i 20-të ai ka qenë objekt i pretendimeve kontradiktore të lëvizjeve kombëtare hebraike dhe arabe, dhe konflikti ka çuar në një dhunë të zgjatur dhe, në disa raste, luftë të hapur. Sidoqoftë, kontrolli mbi këtë rajon është një situatë komplekse dhe në zhvillim. Nuk ka konsensus ndërkombëtar në lidhje me kufijtë, dhe shumë zona të pretenduara nga palestinezët janë okupuar nga Izraelitët për vite me radhë.

Më shumë se 135 vende, anëtare të Kombeve të



Bashkuara, e njohin Palestinën si një shtet të pavarur, por Izraeli dhe disa vende të tjera, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara, nuk e bëjnë këtë dallim.

RRËNJËT E HERSHME TË PALESTINËS

Studiuesit besojnë se emri "Palestinë" fillimisht vjen nga fjala "Filistia", e cila u referohet Filistinëve që pushtuan një pjesë të rajonit në shekullin e 12-të para Krishtit.

Gjatë historisë, Palestina është qeverisur nga grupe të shumta, duke përfshirë Asirianët, Babilonasit, Persët, Grekët, Romakët, Arabët, Fatimidët, Turqit Selxhukë, Kryqtarët, Egjiptianët dhe Mamelukët.

Pas periudhës romake emri nuk kishte status zyrtar deri pas Luftës së Parë Botërore dhe përfundimit të sundimit nga Perandoria Osmane, kur u miratua për një nga rajonet e mandatuar në Britaninë e Madhe; përveç një zone që përfshin, afërsisht, Izraelin e sotëm

dhe Bregun Perëndimor, mandati përfshinte territorin në lindje të lumit Jordan, që tani përbën Mbretërinë Hashimite të Jordanisë, të cilën Britania e vendosi nën një administratë të veçantë nga ajo e Palestinës, menjëherë pas marrjes së mandatit për territorin.

Afërsisht nga viti 1517 deri më 1917, Perandoria Osmane sundoi pjesën më të madhe të rajonit. Kur Lufta e Parë Botërore përfundoi në 1918, Britanikët morën kontrollin e Palestinës. Lidhja e Kombeve lëshoi një mandat britanik për Palestinën - një dokument që i dha Britanisë kontrollin administrativ mbi rajonin dhe përfshinte dispozita për krijimin e një atdheu kombëtar hebre në Palestinë - i cili hyri në fuqi në 1923.

NDARJA E PALESTINËS

Në 1947, pas më shumë se dy dekadave të sundimit britanik, Kombet e Bashkuara propozuan një plan për ndarjen e Palestinës në dy seksione: Një shtet i

pavarur hebre dhe një shtet i pavarur arab. Qyteti i Jeruzalemit, i cili u pretendua si kryeqytet nga hebrenjtë dhe arabët palestinezë, do të ishte një territor ndërkombëtar me një status të veçantë.

Udhëheqësit hebrenj e pranuan planin, por shumë arabë palestinezë - disa prej të cilëve kishin luftuar në mënyrë aktive interesat britanike dhe hebraike në rajon që nga vitet 1920 - e kundërshtuan ashpër atë.

Grupet arabe argumentuan se ata përfaqësonin shumicën e popullsisë në rajone të caktuara dhe duhet t'u jepej më shumë territor. Ata filluan të formonin ushtri vullnetare në të gjithë Palestinën.

IZRAELI BËHET SHTET

Në maj 1948, më pak se një vit pasi u prezantua Plan i Ndarjes për Palestinën, Britania u tërhoq nga Palestina dhe Izraeli e deklaroi veten një shtet të pavarur, duke nënkuptuar një gatishmëri për të zbatuar Planin e Ndarjes.

Pothuajse menjëherë, ushtritë fqinje arabe u zhvendosën për të parandaluar krijimin e shtetit izraelit. Lufta Arabo-Izraelite e vitit 1948 që pasoi përfshiu Izraelin dhe pesë kombe arabe - Jordaninë, Irakun, Sirinë, Egjiptin dhe Libanin. Deri në fund të luftës, në korrik 1949, Izraeli kontrolloi më shumë se dy të tretat e ish Mandatit Britanik, ndërsa Jordania mori kontrollin e Bregut Perëndimor, Egjiptit dhe Rripit të Gazës.

Konflikti i vitit 1948 hapi një kapitull të ri në luftën mes hebrenjve dhe arabëve palestinezë, i cili tani u bë një garë rajonale që përfshinte shtetet kombëtare dhe një lëmsh interesash diplomatike, politike dhe ekonomike.

OÇP/PLO U THEMELUA

Në 1964, Organizata Çlirimtare e Palestinës (Palestine Liberation Organization - PLO) u formua me qëllim të krijimit të një shteti Arab Palestinez në tokën e administruar më parë nën Mandatin Britanik, dhe të cilën PLO e konsideroi të pushtuar në mënyrë të paligjshme nga Shteti i Izraelit.

Megjithëse PLO fillimisht i ishte kushtuar shkatërrimit të shtetit të Izraelit si një mjet për të arritur qëllimin e tij për shtetësinë palestineze, në Marrëveshjet e Oslos 1993, PLO pranoi të drejtën e Izraelit për të ekzistuar në këmbim të njohjes zyrtare të PLO nga Izraeli - u duk si një shenjë pozitive në marrëdhëniet izraelito-palistineze.

Në 1969, udhëheqësi i njohur palestinez Jasser Arafat u bë Kryetari i PLO dhe e mbajti atë titull derisa vdiq në 2004.

LUFTA GJASHTË DITORE

Lufta Gjashtë Ditore u shkaktua gjatë një

periudhe të paqëndrueshme fërkimesh diplomatike dhe përleshjesh midis Izraelit dhe fqinjëve të tij. Në prill 1967 përplasjet u përkeqësuan, pasi Izraeli dhe Siria luftuan me një angazhim të egër ajror dhe artilerie, në të cilin u shkatërruan gjashtë avionë luftarakë sirianë.

Në vazhden e betejës ajrore të prillit, Bashkimi Sovjetik i siguroi Egjiptit informacione se Izraeli po lëvizte trupat në kufirin e tij verior me Sirinë në përgatitje të një pushtimi në shkallë të plotë. Informacioni ishte i pasaktë, por gjithsesi nxiti Presidentin Egjiptian Xhemal Abde'l-Nasser për të çuar përpara forcat në Gadishullin Sinai, ku ata dëbuan një forcë paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara që kishte ruajtur kufirin me Izraelin për më shumë se një dekadë.

Forcat e Mbrojtjes së Izraelit më pas filluan një sulm ajror parandalues kundër Egjiptit më 5 qershor 1967. Të dy kombet pretenduan se po vepronin në vetëmbrojtje në konfliktin pasues, i cili përfundoi më 10 qershor dhe gjithashtu u tërhoq në Jordan dhe Siri, të cilët morën anën e Egjiptit. Lufta Gjashtë Ditore, siç u quajt, rezultoi në fitime të mëdha toke për Izraelin.

Në fund të luftës, Izraeli kishte marrë nën kontroll Rripin e Gazës, Bregun Perëndimor, Gadishullin Sinai (një rajon i shkretëtirë i vendosur mes Detit Mesdhe dhe Detit të Kuq) dhe Lartësive Golan (një pllajë shkëmbore mes Sirisë dhe Izraelit modern).

Rezultati i Luftës Arabo-Izraelite të vitit 1967 do të çonte në tension të vazhdueshëm dhe konflikt të armatosur mes Izraelit dhe fqinjëve të tij gjatë dekadave të ardhshme.

INTIFADA E PARË DHE MARRËVESHJET E OSLOS

Në vitin 1987, shpërtheu Intifada (Kryengritja) e Parë, një valë e zemërimit palestinez për pushtimin e vazhdueshëm izraelit të Gazës dhe Bregut Perëndimor. Grupet e milicisë palestineze u rebeluan dhe qindra njerëz u vranë.

Një proces paqësor pasues, i njohur si Marrëveshjet e Paqes në Oslo, filloi gjatë fillimit të viteve 1990 në një përpjekje shumëpalëshe për t'i dhënë fund dhunës së vazhdueshme.

Marrëveshja e parë e Oslos (Oslo I) krijoi një kalendar për një proces paqësor në Lindjen e Mesme dhe një plan për një qeveri të përkohshme palestineze në pjesë të Gazës dhe Bregut Perëndimor. Marrëveshja u nënshkrua në 1993 dhe u dëshmuua nga Kryeministri izraelit Yitzhak Rabin dhe udhëheqësi palestinez Jasser Arafat.

Arafat u kthye në Gaza në 1994 pasi u internua për 27 vjet. Ai kryesoi Autoritetin Palestinez të sapo-formuar.

Në 1995, Oslo II hodhi bazat për një tërheqje të plotë të trupave izraelite nga pjesë të Bregut Perëndimor dhe zona të tjera. Ai përcaktoi gjithashtu një orar për zgjedhjet e Këshillit Legjislativ Palestinez.

Fatkeqësisht, Marrëveshjet e Oslos dështuan në qëllimin e tyre përfundimtar për të sjellë Izraelin dhe Palestinezët të bien dakord mbi një plan të plotë paqësor.

INTIFADA E DYTË: DHUNA VAZHDON

Në Shtator 2000, filloi Intifada e Dytë Palestineze. Një nga shkaktarët e dhunës ishte momenti kur Ariel Sharon, një Hebre Izraelit, i krahut të djathtë, i cili më vonë do të bëhej kryeministri i Izraelit, vizitoi vendin e shenjtë të myslimanëve në xhaminë Al-Aksa në Jeruzalem. Shumë palestinezë menduan se ky ishte një veprim fyes dhe ata protestuan.

Më pas shpërthyen trazira, bomba vetëvrasëse dhe sulme të tjera, duke i dhënë fund procesit paqësor dikur premtues.

Kjo periudhë dhune midis palestinezëve dhe izraelitëve zgjati gati pesë vjet. Jasser Arafat vdiq në nëntor 2004 dhe deri në gusht të vitit 2005, ushtria izraelite u tërhoq nga Gaza.

Në vitin 2006, Hamas, një shkurtim për Lëvizjen Islamike të Rezistencës - fitoi zgjedhjet legjislative Palestineze. Po atë vit, filluan luftimet mes Hamasit dhe Fetahut, grupi politik që kontrollonte PLO-në. Në vitin 2007, Hamasi mundi Fetahun në një betejë për Gazën.

Hamasi dhe Izraeli luftuan njëri-tjetrin në disa luftëra të përgjakshme, duke përfshirë Operacionin Cast Lead, në dhjetor 2008, Operacionin Shtylla e Mbrojtjes në nëntor 2012 dhe Operacionin Protective Edge në korrik 2014.

Në prill 2014, Hamas dhe Fetah ranë dakord për një marrëveshje që do të formonte një qeveri të unifikuar kombëtare Palestineze.

SHTETI AKTUAL I PALESTINËS

Palestinezët ende po luftojnë për një shtet zyrtar, që është njohur zyrtarisht nga të gjitha vendet. Megjithatë palestinezët zënë zona kyçe të tokës, duke përfshirë Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës, disa izraelitë, me bekimin e qeverisë së tyre, vazhdojnë të vendosen në zona që janë rënë dakord në përgjithësi të jenë nën kontrollin e Palestinës. Shumë grupe të të drejtave ndërkombëtare i konsiderojnë vendbanime të tilla të paligjshme, kufijtë nuk janë të përcaktuar qartë, dhe konflikti i vazhdueshëm vazhdon të jetë normë. Një pjesë e konsiderueshme e izraelitëve gjithashtu kundërshtojnë vendbanimet dhe do të preferonin të gjenin mënyra paqësore për të zgjidhur

mosmarrëveshjet e tyre tokësore me palestinezët.

Në maj 2017, udhëheqësit e Hamasit paraqitën një dokument që propozonte formimin e një shteti palestinez, duke përdorur kufijtë e përcaktuar më 1967, me Jeruzalemin si kryeqytetin e tij. Sidoqoftë, grupi refuzoi të njohë Izraelin si shtet dhe qeveria izraelite e refuzoi menjëherë planin.

Në maj 2018, tensionet shpërthyen kur Ambasada Amerikane u zhvendos nga Tel Aviv në Jeruzalem. Duke e perceptuar këtë si sinjal të mbështetjes amerikane për Jeruzalemin si kryeqytetin e Izraelit, palestinezët u përgjigjën me protesta në kufirin Gaza-Izrael, të cilat u takuan me forcën izraelite, duke rezultuar në vdekjen e dhjetëra protestuesve.

Ndërkohë, ndërsa në progresin e vitit 2019, banorët e Gazës panë një lehtësim teksa Izraeli lehtësoi bllokadën e tij. Izraeli kërkonte të negocionte një mirëkuptim afatgjatë me Hamasin që do të zvogëlonte dhunën. Negociatat e ndërmjetësuara nga Egjipti vazhduan në vitin 2020.

Përfundimi i një presidenti të ri të SHBA në 2021 solli shpresë për një afim midis PA (Autoritetit Palestinez) dhe Shteteve të Bashkuara. Në të vërtetë, Shtetet e Bashkuara filluan rivendosjen e ndihmës për PA dhe u zotuan të rihapnin zyrën e PLO në Uashington, DC. Abbas njoftoi planet për të mbajtur zgjedhjet parlamentare në maj dhe zgjedhjet presidenciale në korrik, të cilat shumë vëzhgues besuan se kishin për qëllim të mbështesnin legjitimitetin e qeverisë së udhëhequr nga Abbas, ndërsa sinjalizuan vendosmërinë për të rinovuar procesin e paqes. Në fund të prillit, megjithatë, Abbas shtyu zgjedhjet për një kohë të pacaktuar mes shqetësimeve se Izraeli do të parandalonte votimin në Jeruzalemin Lindor - një arsye e përmendur për anulimin e zgjedhjeve në të kaluarën.

Prilli gjithashtu pa tensione të reja në Jeruzalem. Ndërsa policia izraelite kufizoi hyrjen e Palestinezëve në Qytetin e Vjetër për lutjet e Ramazanit, si Palestinezët ashtu edhe Hebrenjtë ranë viktime të dhunës në rrugë. Tensionet erdhën në krye të majit ndërsa Gjykata e Lartë e Izraelit ishte vendosur të jepte një vendim për dëbimin e dhjetëra familjeve palestineze nga shtëpitë e tyre në lagjen Sheikh Xharrah. Vendimi u vonua mes tensioneve të shtuara, por përplasjet pranë Xhamisë Al-Aksa çuan në qindra plagosje. Për herë të parë, që nga viti 2014, Hamas lëshoi një raketë në Jeruzalem si përgjigje, shumica e të cilave ranë në fusha të zbrazëta.

Në sajë të kësaj historie të Palestinës që ka përfshirë gjakderdhje, zhvendosje dhe paqëndrueshmëri, shumë udhëheqës botërorë vazhdojnë të punojnë drejt një rezolute që do të rezultojë në paqe në të gjithë rajonin.



HAXHI ALI DERHEMI
(1850-1938)

**KRYETAR I BASHKISË SË TIRANËS
(1923-1924).
I DEKORUAR ME URDHRIN
“SKËNDERBEU” KLASI I, 1937**

Lindi në Tiranë, në një familje fisnike, autoktone, rreth vitit 1850. I ati i tij, Hasan Derhemi, ka qenë intelektual i shquar i kohës, jurist, inspektor gjyqesh për vilajetin e Shkodrës. Ali Derhemi, pas medresesë në Tiranë, mbaroi shkollën ekonomike osmane dhe për vite ka qenë inspektor financash për Kavajën, Durrësin, Shijakun etj.

Bashkëkohësit e tij e mbajnë mend si njeri shumë të zgjuar dhe bamirës. Vite me radhë ka dhënë lëndën e matematikës në medrese. Nga fillimi i viteve 20 të shek. XX e në vazhdim, disa herë radhazi është zgjedhur anëtar i Këshillit Bashkiak të Tiranës, kurse në vitet 1923-1924, zv/kryetar i Bashkisë. Më vonë, deri sa ndërroi jetë, ka punuar në Komunitetin Mysliman. Qeveria e Ahmet Zogut, duke vlerësuar shumë veprimtarinë e tij në dobi të popullit shqiptar, me rastin e 25 vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, së bashku me atdhetarë të tjerë të shquar e dekoroi me Urdhrin e Skënderbeut të Klasit I.¹

Njerëzit e shquar nuk i kanë munguar asnjëherë vendit tonë, sidomos në situatat e vështira që ka kaluar populli shqiptar. Kështu, pas shpalljes së Pavarësisë më 1912, u pa e domosdoshme krijimi i institucioneve të një shteti sovran.

Në krye të këtyre teologëve atdhetarë të shquar, që veprimet e tyre gjithmonë i kanë bazuar në ndjenjat fetare e atdhetare, ishte Haxhi Vehbi Dibra, që u ndoq nga shumë shokë, të cilët, nëpërmjet Kongresit Mysliman të mbajtur nga fillimi i viteve '20 të shek. XX, themeluan Komunitetin Mysliman të Shqipërisë. Krijimi i Komunitetit duhej dhe u shoqërua me një radhë masash administrative si:

1. Hartimi i dokumentacionit ligjor për mbarëvajtjen e institucionit të Fesë islame në Shqipëri.

2. Ndarja administrative e shoqëruar me emërimin e kuadrit përkatës: myfti, imam, vaiz, etj.

3. Rregullimi dhe inventarizimi i pasurive vakfnore.

4. Vendosja mbi baza specifike për vendin tonë e arsimimit të kuadrit fetar.

5. Propaganda: botimi i revistës dhe librave, etj.

Haxhi Ali Derhemi ka qenë gjithashtu edhe në detyrën e zv/kryetarit të Komunitetit Mysliman Shqiptar. Disa vite më vonë, në administratën e Komunitetit, u bënë ndryshime, p.sh. Haxhi Vehbi Dibra, nga kryetar u bë kryemyfti, kështu edhe Haxhi Ali Derhemi, nga zv/kryetar u bë ndihmëskryemyfti, post në të cilin qëndroi derisa ndërroi jetë, më 1938.

Për sa i përket punës së tij si zëvendës i Haxhi Vehbi Dibrës, krahas ndihmës së madhe në Komunitetin Mysliman, vlen të përmendet se, si ekonomist që ishte, ndihmoi shumë në evidentimin dhe inventarizimin e pasurisë së patundshme të vakfeve në Shqipëri, si edhe në konsolidimin e administratës vakfnore.

Për sa i përket shpirtit të tij si besimtar e klerik i devotshëm, sot mund të shkruhen shumë gjëra për të dëshmuar cilësitë e virtytet e tij të larta, por këtu mund të përmendim një shkrim të botuar në revistën "Zani i Naltë, nr. 2-3 tetor, nëntor 1933, me titull: "Vepra shpirtërore e Haxhi Ali Derhemit, ndihmës i kryemyftiut, ku midis të tjerash thuhet se "Hirësija e tij Haxhi Ali Derhemi, i frymëzuem nga shpirti i naltë i vet, ka vendosur që pasurinë që ia ka falë i madhi Zot, ta shpenzojë në rrugë të Zotit, dhe kështu ka projektuar një plan për me krye disa vepra të pavdekuna... meremetimin e xhamisë së Shehit të vogël, duke shpenzuar 900 franga ari dhe së shpejti do të fillojë meremetimin e xhamisë së Tetovës etj".

I tillë klerik i devotshëm ka qenë ai dhe sa jetoj, gjithçka: mendje, zemër e pasuri, ia kushtoi idealit, Islamit. Ndërroi jetë dhe u përcoll shumë i nderuar e i respektuar nga populli i kryeqytetit në vitin 1938.

1. Basha, Ali, gazeta "Drita Islame", nr. 11 (72), qershor, 1995: 3.

Kamisa Mbret
ELBASAN



Xhamia Mbret, një nga faltoret më të hershme të Shqipërisë, e ndodhur brenda lagjes "Kala", në distancë të afërt me portën kryesore të hyrjes, edhe sot vazhdon ta ruajë formën e saj të themelimit.

Për ndërtimin e saj hidhen disa hipoteza nga historianë, arkeologë e studiues të ndryshëm; ajo mund të jetë ndërtuar nga ushtarët e sulltanit njëkohësisht me rindërtimin e kalasë.

Në hyrje të saj, mbi murin anësor të portës së madhe, shkruhet me germa të mëdha XHAMIA MBRET, një xhami mbretërore, që sipas versionit zyrtar të historisë, është ndërtuar nga sulltan Bajaziti II, më 1492.

Në fillim shekullin e XX-të e në vijim, ajo vinte e dyta në radhë, pas xhamisë së ndërtuar nga Sulltan Mehmeti II, në vitin 1464, kur u ndërmorën shumë punime për restaurimin e mureve rrethuese brenda kalasë.

Nga pikëpamja stilistike, kjo faltore përputhet me të gjitha xhamitë e tjera të emëruara mbretërore, që u ndërtuan nga Sulltan Bajaziti II, në fund të shekullit XV-të në Përmet, Gjirokastër, Berat, Shkodër dhe në Elbasan.

Xhamia Mbret përfaqëson tipin e faltores me sallë të mbushur, çati druri dhe hajat përpara hyrjes. Salla e faltores ka një hapësirë relativisht të madhe dhe tërthor aksit të saj ndodhen tri kolona druri, për arsye konstruktive të mbajtjes së çatisë dhe për të krijuar një mjedis ndarës të sallës, nga pjesa e mafilit, të cilat janë karakteristike për këtë lloj kompozimi të faltoreve të hershme islame.

Në krah të majtë janë ndërtuar banjat dhe hamami,

sipas kohëve moderne, pasi ato të parat nuk u kanë rezistuar dot kohëve. Në të djathtë ngrihet ndërtesa e vjetër e xhamisë me një strehëz prej druri në formën e një gjysmë trekëndëshi mbi të cilën vitet kanë lënë gjurmë.

Strehëza mbulon pjesën e verandës së xhamisë, e cila rrethohet nga parmakët prej druri ku duket qartë vjetërsia e tyre.

Brenda kësaj xhamie forma paraqitet mjaft e mirë dhe koherente. Xhamia merr dritë nga katër dritaret në secilën faqe. Minarja e rindërtuar së fundmi është e ulët si lartësi, por kalon mjaft bukur trupi në ballkonin e sherifasë e me seksion më të ngushtë në pjesën e sipërme, ku mbështetet koni i majës, i realizuar me fletë metalike prej plumbi.

Hajati i xhamisë ka qenë i realizuar prej strukturash druri, pothuajse me të njëjtën mënyrë, me përjashtim të atij të rikonstruktuar në vitet e fundit të shekullit të XX dhe sot mbahet pastër nga besimtarë të shumtë myslimanë, të cilët në çdo vakt kryejnë edhe ritin e faljes.

Po t'i referohesh fakteve të sotme, në qytetin e Elbasanit, me rreth 140 mijë banorë, janë vetëm 5 xhami, si xhamia Mbret brenda kalasë së qytetit, xhamia e Pashës në vendin e quajtur "Tri Urat", xhamia e Nazareshës në jug të qytetit, xhamia në lagjen "Skënderbej" dhe xhamia më e re El-Hagri.

Ndërkohë që në qytet kanë qenë mbi 20 xhami, mes të cilave dallonin xhamia e Ballijes dhe ajo e Agait, të cilat u prishën nga regjimi komunist.

Frika nga vdekja

në një këndvështrim ndryshe...

Kërkimi i përjetësisë nga ana e njeriut, ose thënë ndryshe frika nga vdekja, ka filluar që me lindjen e tij. Nuk është rastësi përmendja e vdekjes dhe jetës së përtejme edhe te librat apo broshurat më të vjetra të kohëve.

Frikën nga vdekja e mësojmë që në moshë të vogël. Mos vallë kjo frikë, e cila qëndron përballë nesh si një dallgë e fortë gjatë procesit të socializimit, është arkitektja e padukshme e jetës sonë? Nëse e shohim nga ana historike frika nga vdekja i ka bashkuar njerëzit më pranë njëri-tjetrit, i ka edukuar, zhvilluar dhe strukturuar. Frika mundëson lindjen e mekanizmave që mbajnë në këmbë individin dhe shoqërinë. Për këtë arsye frika ka qenë edhe instrumenti më themelor në drejtimin e njerëzve gjatë historisë. Por ne, në këtë shkrim, do të fokusohemi te ndikimi i frikës në jetën e njeriut, duke mos e trajtuar si një realitet objektiv siç është vdekja.

Nëse frika nga vdekja nuk do të ishte e vazhdueshme, atëherë do të ishte e pamundur të harxhonim energji të vazhdueshme për të mbrojtur jetën. Nëse shohim edhe anën individuale të çështjes përballemi me historinë tonë njerëzore. Ekziston një ndryshim mes frikës nga vdekja të një të rrituri me atë të fituar në fëmijëri. Nevojat e fëmijës janë në të shumtën e rasteve, instiktive. Lidhja e forte që ka me prindin është përcaktuese në të gjitha ndjenjat dhe mendimet e tjera. Plotësimi i nevojave ditore të tij e lumturon atë, dhe e gjithë kjo vendoset në thellësitë e vetëdijes së fëmijës. Bashkë me plotësimin e kërkesave themelore fëmija gëzohet, ndihet e vlerësuar dhe i vendosur. Aty nuk mund të bëhet fjalë për ndonjë frikë apo shqetësim subjektiv. Për sa kohë fëmija nuk largohet nga nëna dhe babai asnjë lloj frike nuk mund të trokasë në derën e tij. Kur ushqehet dhe i plotësohen dëshirat nuk mund të mërzitet. Njeriu mund të piqet edhe me anë të frikës subjektive. Fëmija bëhet më i pjekur duke pasur frikë. Ai fillon të hedhë hapa të detyruar drejt njerëzores kur frika e tij kalon mungesën e prindërve dhe përballjen me koncepte subjektive. Nën ankthin e vdekjes qëndron ankthi i jetës. Personi i cili e ka frikë vdekjen në të vërtetë ka frikë jetën. Përjeto e njeriut drejt qetësisë, rehatisë, ekuilibrit është e lidhur ngushtë me ndjenjën për vdekjen të mbartur thellë brenda vetes.

Të gjithë e dimë se kafshët nuk kanë frikë subjektive. Për shembull një gazelë mund të vazhdojë të ushqehet në të njëjtin vend ku më parë një luan ka ngrënë një gazelë tjetër. Gazela do të mërzitet pak vetëm kur të humbë njërin nga prindërit. Parë nga ky aspekt frika nga vdekja tregon një ndryshim thelbësor të rëndësishëm mes njeriut dhe krijesave të tjera. Nuk arrijmë të përcaktojmë se cilat aftësi apo fiksime (mani???) do të zhvillojë në të ardhmen kjo lloj frike. Ky është një proces kompleks njohës, i cili ndryshon nga një njeri te tjetri. Padyshim që njeriu fillon të ndërtojë personalitetin e tij në momentin që tenton të shtypë frikën nga vdekja.

Megjithëse vdekja dhe jeta duken si dy koncepte

të kundërta, në të vërtetë ato ngjajnë me dy pemë degët e të cilave janë të lidhura me njëra-tjetrën. Çdo njeri që vjen në këtë jetë një ditë do të vdesë.

Fryti i parë i vdekjes është morali

Është e pamundur që vdekjen ta pasqyrojmë si diçka objektive. Çdo ditë mund të përballemi me vdekjen, me humbjen e një njeriu të dashur dhe me boshllëkun që lë brenda nesh. Por kjo nuk do të thotë që ne nuk mund të zhvillojmë një politikë mendore dhe ndjesore ndaj realitetit shkatërrues të vdekjes.

Ekzistenca e vdekjes e përball njeriun me një realitet pas vdekjes. Meqë jemi të vdekshëm, atëherë nuk mund të bëjmë zgjedhje të rastësishme dhe të veprojmë sipas instinkteve tona. Duhet të jemi njerëz, të cilët llogarisin në mënyrë të përgjegjshme çdo moment. Filozofi i njohur Kindi, në librin e tij 'Rrugët e shpëtimit nga mërzia', analizon frikën e vdekjes dhe thekson se te frika e vdekjes në të vërtetë qëndron epshi dhe zemërimi, dy ndjenja që kanë skllavëruar edhe mbretërit Sipas Kindit, vdekja është pjesë e natyrshmërisë së njeriut dhe nuk duhet pasur frikë nga ajo. Pjesa më e madhe e njerëzve e quajnë vdekjen fatkeqësi dhe nuk e pëlqejnë. Nëse njerëzit do të mendonin në mënyrë të shëndetshme rreth saj do të kuptonin se ajo është një gjë e mirë, sepse vdekja është plotësuesja e njerëzores. Po të mos ishte vdekja nuk do të ishte as njeriu.

Njeriu duhet ta ketë frikë mungesën e vdekjes. Mungesa e vdekjes mund të na shtyjë të jemi më pesimistë ndaj të kësaj dhe padrejtësive që ndodhin në tokë. Ndikimi i parë i vdekjes në jetën shoqërore është morali. Besimi në jetën e përtejme është një domosdoshmëri jetësore për çdo njeri me arsye të shëndoshë.

Zbulimi ekzistencial

Mendimi ekzistencial i shfaqur në periudhën moderne e sheh frikën nga vdekja si paradoksin themelor të njeriut, që e shtyn atë të gjejë kuptimin e vërtetë të jetës. Njeriu, dashur pa dashur, përball me vdekjen dhe me pyetje të shumta, përgjigjet e të cilave përcaktojnë kuptimin e jetës. Tronditja e përjetuar përballë vdekjes i jep kuptim më të plotë jetës. Koha dhe vdekja na ndihmojnë të kuptojmë kufizimin tonë si krijesa dhe rëndësinë e vendimeve të marra.

Ndërkohë që vdekja konsumon jetën, frika nga vdekja nxit jetën dhe e ndërton atë. Kjo frikë ka qenë dhe do të jetë brenda nesh dhe shumë sjellje apo reagime lindin nga dëshira për ta shtypur këtë frikë. Frika nga vdekja do të ekzistojë gjithmonë dhe në çdo vend dhe është aq e madhe sa një pjesë e madhe e jetës së njeriut harxhohet për ta mohuar atë.

Frika nga vdekja na lartëson deri në qiej, por edhe na lidh me tokën. Ndërkohë që njeriu sheh vdekjen, në të vërtetë ka parë veten e tij, është përballur me veten. Çdo sekondë e jetës së njeriut fiton një kuptim të veçantë.

NJË TEKNOLOGJI PREMTUESE PËR TERAPINË TUMORALE RADIOTERAPIA FLASH

Radioterapia FLASH është një model i ri i terapisë rrezatuese, që mund të administrohet te një pacient me kancer brenda një trajtimi të vetëm, të plotë. Terapia zgjat më pak se një sekondë dhe ka një kohëzgjatje të efektit deri në gjashtë javë. Krahasimisht, terapia rrezatuese konvencionale kërkon disa minuta për të administruar të njëjtën dozë.

Hyrje

Radioterapia është një nga mjetet terapeutike mbizotëruese shkencore për tumoret. Qëllimet e radioterapisë janë të dyfishta; e para prej të cilave qëndron në vrasjen me sukses të qelizave tumorale me rrezatim jonizues dhe e dyta është, në të njëjtën kohë, minimizimi i dëmtimit të indeve normale gjë e cila ndikon negativisht në kujdesin dhe cilësinë e jetës së personit të prekur. Është vlerësuar se deri në 65% e pacientëve me tumor kalojnë në radioterapi në një moment gjatë trajtimit të tyre. Gjëja e parë që duhet bërë për të arritur këto qëllime është depozitimi i një sasive të lartë rrezatimi jonizues të fuqishëm në një tumor, ndërsa në të njëjtën kohë të shmanget rrezatimi i indeve të rregullta. Dekadat e fundit kanë parë një rritje të teknologjive të reja më superiore, që përbëhet nga radioterapia me intensitet të moduluar, radioterapia stereotaktike e trupit, radioterapia e protoneve dhe grimcave të karbonit. Këto pajisje dhe teknika të reja e kanë shndërruar radioterapinë në një rutinë të veçantë dhe terapi efektive për shumicën e të sëmurëve me kancer me ndihmën e përdorimit të administrimit të zgjeruar të dozës për sipërfaqe trupore.

Gjëja e dytë për të arritur rrezatimin e suksesshëm është rritja e reaksionit diferencial mes indeve të rregullta

dhe tumoreve, për të jonizuar rrezatimin me ndihmën e përdorimit, për shembull, të një terapie strategjike të hiper-fraksionuar. Radioterapia konvencionale (CONV-RT) përmban fraksione të dy Gy (ose "gri"; një matje e përdorur për rrezatim) në ditë për pesë ditë (nga e hëna në të premte) çdo javë për disa javë në vazhdim, duke lejuar që indet e rregullta të rikuperojnë dëmtimin e përshpejtuar nga rrezatimi, që rezulton në një sasi më të madhe sesa tumoret. Kohët e fundit, një metodë e tretë për të arritur këtë qëllim të saktë, e njohur si FLASH-RT, u shfaq si një pajisje e re premtuese në paraqitjen e administrimit kohor të një doze të vetme të rrezatimit jonizues me dozë të lartë.

Çfarë të rehash ka në terapinë e rrezatimit?

RT konvencionale është zhvilluar ndjeshëm me kalimin e kohës. Sidoqoftë, dëmi i precipituar në indet e shëndetshme, në një moment të terapisë rrezatuese, vazhdon të jetë një detyrë jetike për RT tradicionale.

FLASH RT përfaqëson një zhvendosje të tërë arketipale në krahasim me një përmirësim të epokës aktuale të teknologjisë së radioterapisë. Shumëllojshmëria e kërkimeve vazhdimisht rritet në një akumulim të rezultateve premtuese. FLASH RT është mbase një nga teknologjitë më premtuese për terapinë tumorale, duke dhënë pamje vitale për studimet paraklinike.

Avantazhet e terapisë së rrezatimit FLASH krahasuar me terapinë konvencionale të rrezatimit

FLASH RT plotëson ndikimin diferencial midis tumoreve dhe indeve të shëndetshme. FLASH RT ofron doza të mëdha në një kohë jashtëzakonisht të shkurtër rrezatimi si një "ndeje" e shpejtë e rrezatimit. FLASH RT është po



aq i fuqishëm në krahasim me normën standarde të dozës RT, duke ulur kështu toksicitetin e rregullt të indeve dhe efektet anësore.

Radioterapia konvencionale (RT) është e kufizuar në mënyrë të konsiderueshme nga toksiciteti i indeve të rrezatuara nga rrezatimi. Nëse ai mund të zvogëlohet, atëherë mund të jepet një dozë shtesë rrezatimi, duke lehtësuar kështu një reagim më të mirë ndaj tumorit.

Administrimi ultra i shpejtë i terapisë rrezatuese (d.m.th., elektronet, fotonet / rrezet x dhe rrezet e protoneve) me dozë të madhe është më me rëndësi sesa ai që përdoret aktualisht dhe zvogëlon toksicitetin e precipituar nga rrezatimi. Kjo lejon që fazat e rregullta të tolerancës së indeve të tejkalohen ndjeshëm, duke rritur kështu indeksin e shërimit mbi administrimin tradicional të rrezatimit.

Në radioterapinë tradicionale të rrezeve të jashtme (EBRT), personi i prekur rrezatohet për 1-2 minuta, 5-ditë / javë, për 1-2 muaj. Në FLASH-RT, personi i prekur mund të rrezatohet në <0,1 sekondë për 1 deri në katër ditë, duke ulur ndjeshëm efektet anësore, toksicitetin e rregullt të indeve dhe koston.

Toksiciteti i indeve

Për herë të parë u zbulua në vitet 1960 se qelizat jo-kancerogjene, që u ishin nënshtruar dozave ultra të larta të radioterapisë, kishin më shumë gjasa të ishin të zbatueshme se ato që u nënshtroheshin normave standarde të dozës. Kjo është mbështetur aktualisht me ndihmën e përdorimit të hulumtimeve në minj dhe u vërtetua se kishte shumë më pak dëm në mushkëritë e minjve të trajtuar me FLASH-RT në krahasim me ato të trajtuar me CONV-RT. Në çdo ekzaminim tjetër, minjtë që iu nënshtruan rrezatimit të plotë të trurit në normat e dozës tradicionale ishin më keq në kontrollat e njohjes në krahasim me ato të trajtuar me doza ultra të larta. Një ekzaminim tjetër në lidhje me terapinë e kancereve të hundës në macet me FLASH-RT konfirmoi të gjithë rastet me zhdukje të tumoreve me trauma minimale në indet përreth. Studimi i ndikimit të FLASH është me rëndësi për të vendosur se si mund të përdoret në një situatë shkencore për t'u marrë me shumicën e pacientëve me kancer.

Shumë studime kërkimore tregojnë se më tej, në uljen e toksicitetit të indeve, FLASH-RT gjithashtu prodhon një reagim identik të tumorit si CONV-RT.

Elementët ndikues

Ekziston një varg elementësh që mund të kenë një efekt në efikasitetin e trajtimit FLASH që përfshin shpejtësinë e dozës, dozën e përgjithshme, shpejtësinë e pulsit, fraksionimin dhe modalitetin e rrezatimit. Shkalla e dozës e përdorur për ndikimin e FLASH mund të shkojë, përveç kësaj, duke u mbështetur në indin e prekur dhe mënyrën e administrimit. Shumë studime ndryshojnë në dozën e përgjithshme të rrezatimit të përdorur, ose përdorin doza të pakonceptueshme në skenarë shkencorë, të cilat i komplikojnë gjetjet. Furnizimi me rrezatim është gjithashtu një aspekt, sepse ndikimi FLASH është zbuluar kryesisht duke përdorur përshpejtuesit linearë të elektroneve. Më aktualisht, suksesi i trajtimit FLASH ka qenë gjithashtu i

dukshëm pas përdorimit të protoneve dhe rrezatimit me rreze X. Pulsimi i rrezatimit në një frekuencë të lartë mund të rezultojë në terapi FLASH në një dozë të përshtatshme në përputhje me pulsën. Për më tepër, ekzaminimi kërkohet të verifikojë parametrat e rëndësishëm për induktimin e ndikimit në FLASH, pasi ka një larmi të gjerë të variabëlve në punë.

Mungesa e oksigjenit

Sesi ndodh pikërisht ndikimi i FLASH nuk kuptohet tërësisht por rezultati është hipotetizuar. Indet hipoksike (indet të cilat mund të jenë të dëmtuara nga oksigjeni) janë shumë të imunizuara ndaj rrezatimit (dhe si pasojë ka shumë më pak gjasa të dëmtohen) sesa indet e oksigjenuara mirë. Prandaj është konceptuar që dallimi në toksicitetin e indeve midis FLASH-RT dhe CONV-RT mund të jetë për shkak të shtrirjes së hipoksisë me doza ultra të larta dhe radiorezistencës pasuese të transferuar në indet e rrezatuara.


Ndryshimet në imunitet

Një ide tjetër e propozuar që trajtimi FLASH të ketë një ndikim më të madh është një reagim imunitar i ndryshuar. Meqenëse përdor një kohë më të shkurtër terapie, shumë më pak limfocite (qelizat e bardha të gjakut në imunitet) vuajnë nga rrezatimi. Një ekzaminim përmendi aktivizimin e shumë më pak qelizash imune në minj pas FLASH-RT në krahasim me CONV-RT. Duhet referuar se është shumë e dyshimtë nëse ndonjë reagim imunitar pas FLASH-RT po kontribuon në ndikimin e FLASH ose për shkak të tij. Përgjigjet e tjera organike, që përbëhen nga dëmtimi i ADN-së dhe infeksioni, gjithashtu mund të kontribuojnë, dhe kërkohen studime më të gjera për sqarime.

Përfundim

FLASH-RT siguron një shpërthim të vetëm të rrezatimit jonizues me dozë të lartë në milisekonda dhe arrin afër kontrollit të përsosur të tumorit dhe, në të njëjtën kohë, kursen indet e rregullta nga rezultatet e rrezatimit ekstrem. Rezultati është më se mahnitës deri më sot dhe parashikues i rritjes së rezultateve shkencore për të sëmurët me tumor me ndihmën e përdorimit të modulimit të dozës së radioterapisë. Ndikimi FLASH jep siguri të përparuar të indeve në krahasim me CONV-RT pa kompromentuar terapinë e tumorit. Është studiuar nëpër specie të shumta dhe tani është dokumentuar një rast i vetëm njerëzor. Ndërsa mekanizmi i tij i lëvizjes ka të ngjarë të përmbajë shterimin e oksigjenit, ai nuk kuptohet gjithmonë absolutisht dhe për pasojë kërkon ekzaminime të ngjashme mbështetëse. Dozat e kërkuara, për të marrë ndikimin FLASH, e bëjnë atë të papërshtatshëm për shumë studime të pacientëve. Për më tepër, sigurimi i burimeve të rrezatimit për gjenerimin e rrezeve të përshtatshme për terapinë e secilit tumor sipërfaqësor dhe të thellë është një aspekt parashikues në provat shkencore. Nëse studimet e ardhshme sjellin njohuri më të mira të mekanizmave organikë të ndikimit në FLASH, do të jetë e vlefshme për ta fituar atë në doza të ulura, duke rritur qëndrueshmërinë e tij shkencore.

Përktheu: Erion Sukaj



DY RRËFENJA POPULLORE

Dera misterioze

Tregojnë se shumë kohë më parë, në Kinë, na ishte një perandor i egër dhe i frikshëm. Ai sulmonte vende të tjera, bënte luftëra dhe, përherë, kapte robër. Robërit nuk i vriste, por i çonte në burg dhe, para se ta fuste secilin në qelinë e tij të tmerrshme, i fuste të gjithë në një sallë të madhe, përballë së cilës, ndodhej një derë prej hekuri, mjaft e çuditshme. Në atë derë qenë vizatuar figura njerëzish me kafka të mbushura me gjak dhe vizatime të tjera të frikshme.

Perandori urdhëronte që robërit të grumbulloheshin para kësaj dere dhe pastaj u thoshte:

- Po ju jap mundësinë të zgjidhni midis qëndrimit në qelinë tuaj ose kalimit nëpër këtë derë të mistershme që nuk e di se ku të çon. Zgjidhni dhe merrni!

Ngaqë kalimi në atë derë i frikësonte shumë, të gjithë të burgosurit zgjidhnin të qëndronin në qelitë e tyre.

Lufta kishte mbaruar dhe perandori me një oficer, të cilin e mbante gjithnjë pranë, u ndodhën rastësisht, pranë derës

së mistershme. Oficeri, merr guximin dhe e pyet perandorin:

- Perandori im, a mund t'ju bëj një pyetje?

- Bëje, - i thotë shkurt perandori.

- Përherë kam qenë kureshtar të di se çfarë ka matanë kësaj dere. A mund të më thoni?

Dhe sovrani i përgjigjet:

- Afrohu te dera, hape dhe shikoje vetë se çfarë ka.

Oficeri shkon te dera e mistershme dhe, me shumë frikë, fillon ta hapë. Sa u hap dera, gjithë hapësira brenda sallës u ndriçua nga rrezet e diellit.

Pra, ajo derë e tmerrshme, atë që do të guxonte ta hapte, e çonte në një rrugë të madhe, ku ishte plotësisht i lirë.

Oficeri, i befasuar jashtë mase, kthehet nga perandori, pa ditur çfarë t'i thotë. Dhe perandori, i qetë, i shpjegon:

- Ata vetëm duhej të zgjidhnin. Unë ua dhashë këtë mundësi, por nga frika e hapjes së derës misterioze, ata preferuan sigurinë e burgut, sigurinë e asaj çka njeriu njeh.

Një dhuratë nga Zoti

Nastradini kishte dalë për të shëtitur, kur një bletë e pickon në hundë. Menjëherë, hunda nisi t'i ënjtet aq shumë, sa mullai alarmohet shumë dhe, me vrap, shkon te mjeku. Në rrugë kryqëzohet me një hokatar, i cili, me ta parë, i thotë:

- Nastradin efendi, ku e gjete atë hundë? Me

siguri, ia ke marrë ndonjë gomari.

Dhe Nastradini kthehet e i përgjigjet:

- Po ashtu është. Nuk e paske harruar, zotrote, se, kur Allahu na i ndau gomarin në të dyve, ty të dha mendjen e gomarit, ndërsa mua më dha hundën e tij.





KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË

Kurbani 2021

16.000 ALL - 130 EURO - 150 USD

“Andaj, falu për Zotin tënd dhe ther kurban”

Keuthe, 2

PayPal: @albaniakmsh

BANKA BKT | NR. 110000709 | SWIFT: NCBAALTXXX

IBAN ALL: AL 14 2051 1014 0007 09CL TJCL ALLO

IBAN USD: AL 85 2051 1014 0007 09CL TJCF USDA

IBAN EUR: AL 41 2051 1014 0007 09CL TJCF EURA